



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 114, Prill 2013

Nr. Llog. BKT 410027968, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, 0035692328116, internet: www.shoqatadukagjini.org, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

BASHKË MUND TË BËJMË MË SHUME



6

PARAQITET LIBRI "ATENTATI QË TRONDITI DY SHTETE"

4

I STUDIUESIT, POETI DHE PUBLICISTIT PRELË MILANI

Libri "Atentati që tronditi dy shtete" i studiuesit, poetit dhe publicistit Prelë Milani u paraqit, më datë 6 prill 2013 në auditorin e gjimnazit "Dom Bosko" në Shkodër. Veprimtaria promovuese u organizua nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" me ndihmën bujare të anëtarit të kësaj shoqate, Kolë Çardaku. Merrnin pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, intelektualë, shkrimtarë gazetar të shtypit të shkruar e medieve vizive, studentë dhe banorë nga krahina e Dukagjinit. Aktiviteti filloj me një dokumentar të shkurtër historik me titull "Shala fole e Fatosave të shqiptarizmit".

Pozicioni i Republikës Parlamentare në Shqipëri

Romeo Gurakuqi

Instituti i Historisë Bashkëkohore Universiteti Europian i Tiranës / Republika e dytë parlamentare shqiptare e tranzicionit është në një krizë të rëndë. Tatëpjeten e Republikës, në pikpamje të ruajtjes së parametrave të të qenurit Shtet, mund ta shpëtojë frekuentimin e matutjeshme, për formimin e institucioneve kushtetuese dhe skemës institucionale.

8

Sulltanat osman apo shqiptar?!

PUBLIKUAR FILLIMISHT NË GAZETAT ILLYRIA, REPUBLIKA, LAJM DHE SHEKULLI

Gazeta "New York Times" e datës 26 Prill 1909 (figura për një gjerë) e cili mbrohej nga 4000 ushtarë shqiptarë, dhe dorëzimin e tij. Egzistenca e 4000 ushtarëve elitë shqiptarë në rrethin më të afërt me Sulltanin tregon se ato i përkitnin majës së piramidës ushtarake shqiptare që ishte nën petkun osman/turk. Mijra e mijra të tjerë sulmonin sultanin si "turq të rinj"; ndër këta ishte edhe Esad Pashë Toptani.

2

MUNDESITE QË BASHKERISHTË TË BASHKERENDOHEMI NË LETERSI E KULTURE

3

KY REFERAT U MBAJT NË NJË AKTIVITET KULTUROR NË KOMUNËN E KLINËS NË KOSOVË, ME DATEN 19 PRILL 2013

JETE E HUMBUN

Autori i këtyre kujtimeve Ejëll Çoba (1908-1979), u lind dhe u rrit në një familje të njohur, të fisme dhe patriotike të qytetit të Shkodrës. Pas mësimeve fillore në vendlindje, vijoi për 13 vjet rresht jashtë shteti, në Itali, formimin dhe arsimimin e mëtejshëm, të cilin e kurorëzoi shkëlqyeshëm me çertifikimin "Dottore in Giurisprudenza" pranë Universitetit prestigjioz "La Sapienza" të Romës.

5

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

Mundësoi Botimin:
NDUE FTONI



Sulltanat osman apo shqiptar

PUBLIKUAR FILLIMISHT NË GAZETAT ILLYRIA, REPUBLIKA, LAJM DHE SHEKULLI

Gazeta "New York Times" e datës 26 Prill 1909 (figura përbri) përcjell një lajm mbi sulmin e bërë nga Turqit e Rinj kundër Sulltanit, i cili mbrohej nga 4000 ushtarë shqiptarë, dhe dorëzimin e tij. Egzistenca e 4 000 ushtarëve elitë shqiptarë në rrethin më të afërt me Sulltanin tregon se ato i përkëmbnin majës së piramidës ushtarake shqiptare që ishte nën petkun osman/turk. Mijra e mijra të tjerë sulmonin sultanin si "turq të rinj"; ndër këta ishte edhe Esad Pashë Toptani. Mijra e mijra të tjerë të tjerë ishin në kryengritje kundër osmanëve në tokat shqiptare, gjë që solli pas tre vitesh pavarësinë e një shteti shqiptar. Pa llogaritur ushtarët me porosi, mijra e mijra ushtarë të tjerë shqiptarë ishin të shpërndarë në tërë tokat e zotëruara nga sultanat osman dhe zbatonin urdhërat ushtarake të sulltanit edhe në luftimet në kufinj të sultanatit edhe në shtypjen e kryengritjeve në tokat (edhe ato shqiptare) e zotëruara nga sulltanatit. A nuk pati edhe mijra e mijra të tjerë në poste zyrtare të Sulltanatit, që nga kryeministër e deri tek nëpunësi i thjeshtë, të cilët në shumicën e rasteve vetëm vetes i shërbenin? Vetëm ato 4 000 ushtarë elitë shqiptarë mund ta kishin kapur vetë sa hap e mbyll sytë tërë Sulltanin e qeverinë e tij dhe më pas bashkë edhe me shqiptarët e tjerë mund të bënin tërë popullsinë e sulltanatit që edhe ëndrat t'i kishin shqip. Ç'bënë e ku ishin ato forca, për shembull, kur u sulmua Shkodra dhe Janina gjatë luftës së parë ballkanike më 1913? A i ka pas ndaluar interesi vetjak dhe shpirtvogëlsia ato ushtarakë e zyrtarë shqiptarë që të bëheshin "bukëshkelës" ndaj sulltanatit dhe të bëheshin kultivues të farës arbërore shqiptare? A janë ndër ato të shqetësuar po të dëgjonin për një gjë të lartme siç është ardhmëria e Shqipërisë arbërore? A kanë qenë të lidhur brenda vetvetes prej Besës shqiptare që patën përdorur? A e kanë patur ato ushtarakë e zyr-

tarë fuqinë, dëshirën, vullnetin, njohurinë dhe kuptimin për t'u kthyer apo për t'i shërbyer kudo ku ishin vendit të origjinës, Arbërisë, Shqipërisë, gjuhës shqipe? A ka mundësi ta kenë menduar atë? A mbeti jeta e vepra e tyre një mburrje vetjake apo thashethem edhe sot e kësaj dite?

Një shembull i mbarënjohur dhe heroik është ai i Gjergj Kastriotit, i cili pasi u kthye bashkoi princat shqiptarë dhe organizoi arbërit në një shtet arbëror. A nuk ishin shqiptarët e asaj kohe të cilët edhe pas vdekjes së Gjergj Kastriotit e mbajtën vendin të lirë edhe 10 vjet të tjera, deri kur ra kështjella e Shkodrës më 1478? A nuk ishin shqiptarët e periudhës së Gjergj Kastriotit që më luftën e tyre ngadhënjyese për liri, ndonëse më një çmim shumë të lartë njerëzor, krijuan një zjarr të lirë në shpirtin ilir që nuk shuhet më? A nuk ishin shqiptarët e periudhës së Gjergj Kastriotit që i fituan të tëra betejat ushtarake për 25 vjet rresht kundër osmanllinjve, duke iua hequr kështu përfundimisht osmanllinjve mundësinë e kalimit në gadishullin italian? Ndërsa shqiptarët treteshin në luftimet kundër osmanllinjve dhe përballëshin me varfërinë e shkatërrimet që sillnin luftimet, në gadishullin italian rilindja europiane ngjiste maja zhvillimi që edhe sot janë të paarritshme. Pa atë luftë mbrojtëse që bënin shqiptarët nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit dhe princave të tjerë, bie fjala, a do të kishte patur Leonardo da Vinci dhe vepra të tij? A janë mirënjohës italianët, europianët e mbarë bota për ato sakrificat që bëjnë shqiptarët për të mbrojtur zhvillimin njerëzor dhe kushtet e rilindjes europiane?

E thënë ndryshe, shqiptarët humbën në fillim të shekullit XX atë që njihet tani si Turqi. Ashtu si më 1821-1832 kur për shkaqe të ngjashme dhe të një lufte fetare midis shqiptarëve të besimit mysliman dhe atyre të krishterë ortodoksë, shqiptarët humbën atë që

sot quhet Greqi. Si rrjedhojë, doli një shtet i përbërë nga shqiptarë ortodoksë fundamentalistë që ndryshe njihen tani si grekë. A nuk ndodh edhe tani në Greqi që një grek e thotë në shqip: "Jam grek"? A nuk mendojnë "grekët" si tërë fundamentalistët e tjerë, kudo qofshin e kurdoherë, se duhet të egzistojnë vetëm ato dhe se çdo gjë ka qenë e tyre apo iu përket vetëm atyre? A nuk u gjërojnë "serbët" e "grekët" se aty ku është kisha serbe apo greke është tokë e shtet serb apo grek? Turqia e Greqia janë dy shtete që edhe sot si gjuhë zyrtare (të parë) duhet të kenë shqipen. A nuk ndodhën ato humbje tek shqiptarët për shkak të menduarit e të jetuarit në nivel egzistence, të lënies në mëshirë të fatit? A nuk ndodhën për shkak të qenit të harruar e të panjohur edhe nga të vetët, të izolimit nga njëri-tjetri, të mungesës së rrugëve ndërlidhëse, e si rrjedhim të mosbashkimit me njëri-tjetrin? A nuk ndodhën për shkak të rënies në kurthet e pushtuesve dhe përçarjes së të ligëve, e si rrjedhim gjendeshin të zvogëluar para fuqive të pushtuesve? A nuk ndodhën për shkak të hutisë mendore, të humbjes së vetëdijes nacionale, të harrësës së origjinës, të vogëlsisë shpirtërore, e cila i paaftësonte për të menduar e respektuar përtej vetvetes? A nuk ndodhën për shkak të përçarjes fetare të prodhuar prej organizimit "millet" të sulltanatit osman (në vazhdimësi të atij bizantin) që i organizonte njerëzit sipas besimit fetar? A nuk ndodhën për shkak të mungesës së një ideje, libri dhe shkolle qëndrore nacionale, të mungesës së një qendre apo rrjeti nacional, që duhej të përkujdesej për qenien, sigurinë dhe natyralizimin nacional? A nuk ndodhën për shkak të mungesës së një gjuhe të përbashkët të shkruar dhe të përhapur nëpërmjet librave e shkollave nacionale?

Përpjekjet e rilindasve shqiptarë në shekullin XIX, e para së gjithash të arbëreshëve të Italisë

së Jugut, të cilët qenë të parët që i ranë këmbanës së zgjimit nacional, kanë qenë titanike. Po aq titanike kanë qenë përpjekjet për formimin e një shteti shqiptar të pavarur më 1912, i cili u cun-gua më shumë se gjysma edhe pse shqiptarët me vullnet të lirë deklaruan për një Shqipëri të pavarur sipas kufinjve etnikë të përvijëzuar në katër vilajetet e dukshme shqiptare që egzistonin brenda Sulltanatit osman. A nuk ka qenë e pamundur dhe e papranueshme nga të tjerët të nxirje në pah një nacionalitet si shtet më vite ashtu si e kërkonte Lidhja Shqiptare e Prizrenit më 1878? A nuk ishte në atë kohë një Evropë e besimit të krishterë që synonte të kthente mbrapsh shtrirjen e sulltanatit osman? A nuk vazhdoi sulltanatit osman edhe për 500 vjet të tjera traditën e perandorisë bizantine që t'i organizonte njerëzit, botëkuptimin, zakonet dhe mënyrën e tyre të menduarit sipas besimit fetar? A nuk ishte një sulltanat osman që lejonte të hapëshin vetmë shkolla fetare, vetëm për qëllime fetare, dhe jo shkolla nacionale? A nuk ishte një Rusi cariste që nëpërmjet degës së besimit ortodoks të krishterë përpiquej të zbriste edhe në jug të Evropës? A nuk ishte një kohë që në Evropën Juglindore arbërore shtetet po formoheshin dhe njiheshin prej Evropës së krishterë dhe Sulltanatit mysliman sipas kufinjve të shtrirjes së kishave dhe shtetasit e krijuar po emërtoheshin sipas emrit të kishave përkatëse, bie fjala, asaj greke, bullgare, maqedone, serbe, kroate, rumune? Sa për shtetin që njihet si Mal i Zi, emërtimi ndoqi këtë rrugë: nga Malsi u lexua Malzi prej kronikanëve venedikas, u spjegua Mal i Zi e u përkthye Monte Negro; një emër aspak sllav. A nuk ishte shekulli XIX kur fjala "turk" filloi të përdorej për herë të parë për ato njerëz në Anadoll të besimit mysliman që e mbeshtetnin më shumë sundimin osman?

A nuk është hapi i parë për të

SULTAN'S PALACE IN FOES' HANDS

His Guard of 4,000 Albanians Surrenders to Young Turks and is Disarmed.

HIS FATE WITH PARLIAMENT

Scutari Garrison Also Yields and Army Rules for Present with Martial Law.

CROWD HELPED WITH GUNS

Mingled Fearlessly with Fighters on Saturday, Advised Soldiers How to Attack, and Cheered Them On.

By WILLIAM MAXWELL.

Special Cable to This New York Times. Special to The London Daily Mail.

CONSTANTINOPLE, April 26, 2 P. M. —The Yildiz Kiosk captured at noon today. The garrison of 4,000 Albanians surrendered unconditionally, was disarmed, and marched out of the palace under escort of the Macedonian Army. This action was the result of long negotiations between the Sultan, Sverdrup Pasha, the Grand Vizier, and Edhem Pasha, Minister of War, on one side, and Chudat Pasha, commander of the Parliamentary Army, on the other.

zhdukur një popull fshirja e kujtesës së tij, shkatërimi i librave, kulturës, traditës e historisë së tij? A nuk është hapi i dytë ai i caktimit të disave të shkruajnë libra e të përhapin rrëfime të reja të stisura për atë popull, i krijimit të ndjenjave, zakoneve dhe emocioneve të reja, i krijimit të një kulturë të re gjuhësore dhe të menduarit; domethënë i shpikjes së një historie të re gjoja të trashëguar? A nuk ndodh më pas që shpejt ai nacionalitet, i mishëruar tek njeriu i veçantë i kredhur në detin e interesave dhe ndjenjave vetjake, të harrojë se çfarë është e çfarë qe? A nuk ndihmohet ky qëllim duke i ndryshuar gërmat me të cilat shkruhen emrat e njerëzve, duke vendosur prapashtesa tek ato emra, duke ndryshuar kështu shqiptimin dhe tingëllimin e atyre emrave? A nuk treten dallimet midis nacionaliteteve duke vendosur emra fetarë për të sapolindurit?

A nuk vërtetohet thënia e shkrimtarit Viktor Hugo (1802-1885) se "një popull mund t'i bëjë ballë pushtimit të një ushtrie, por nuk mund t'i bëjë ballë pushtimit prej ideve"? A nuk peshon atëherë rëndë pyetja "të jeshë rrënjë apo gjethë"?

Nga Saimir Lolja

LETER

Kryetarit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj, Kryeredaktorit të gazetës, Lazër Kodra dhe Redaksisë së gazetës "Dukagjini", Shkodër

Puna e Kryesise se Shoqates "Atdhetare-Dukagjini" dhe ne veçanti gazeta "Dukagjini" e ka rritur njohjen e Dukagjinit dhe dukagjinave, kudo ku ajo është lexuar, duke u bërë përherë e më e kërkuar dhe më e dashur për lexuesit e shumtë e dashamires se Dukagjinit se, e trashëguara,

historia, kultura, luftërat e përpjekjet për të mbijetuar mes maleve, por edhe per zhvillimin, integrimin e dukagjinave në kohën e sotme si brenda dhe jashtë atdheut, është pasqyruar ne kete gazete mire dhe me mire po vijon te pasqyrohet.

Per kete, meritojnë falenderi-

met më të sinqerta redaksia e gazetës dhe mundesoret, që e kanë mbajtur aktive këto dhjetë vite, sigurisht me shumë sakrificat.

Por, ne si lexues e gazetës mendojmë që të jenë më pak e ngarkuar faqja e pare me foto ne forme "postrash". Mendo-

jmë se është e arsyeshme të jetë kryartikulli dominant, por dhe shkrimet e tjera me autore që janë te shkruara ne faqet e brendeshme, te jene te ekspozuara edhe ata ne faqen e pare. Kjo vlen edhe per rritjen dhe interesimin me te madh te lexuesve.

Modele te faqeve te para te gazetave ka tregu shumë dhe është mundesi per t'ju pershtatur edhe faqes se pare te gazetës tone.

Meqenëse shoqata ka degë e lexues edhe në rrethe të tjera,

mendojme të ketë edhe ndonjë emër bashkëpunëtori, korrespondenti në këto rrethe, te evidentuara prane redaksise se gazetës meqenëse ka pena shumë cilësore dukagjinase në këto rrethe.

Besojmë se duke na mirëkuptuar do te merret ne konsiderate ky mendim jone.

Nga një grup lexuesish të Gazetës "Dukagjini", ne TIRANE

MUNDESITE QE BASHKERISHTE TE BASHKERENDOHEMI NE LETERSI E KULTURE

KY REFERAT U MBAJT NË NJË AKTIVITET KULTUROR NË KOMUNËN E KLINËS NË KOSOVË, ME DATEN 19 PRILL 2013

Në themelet e një nacionaliteti qëndrojnë identitetet. Dhe këto identitete e kanë rrënjën që në folklorin e atij nacionaliteti. Një komb, që të quhet i tillë, duhet t'i ketë të njëjtësuar këto identitete. Në themelet e Athinës antike apo Firences së Rilindjes evropiane gjejmë pikërisht njëjtësimin e tyre, e jo më kot keto dy kyeqendra sot e asaj dite kulmojnë kulturën dhe domethënien dhe deshiren e të gjithëve për t'u evropianizuar. Në një vend, si ky i yni, është pak e vështirë të realizosh të duhuren, të nevojshmen, të arsyeshmen, të vlefshmen dhe në fund të fundit të domosdoshmen. Nëse identiteti nënkupton Gjuhë të njëjtë, folklore të njëjtë, heronjë kombëtar të njëjtë, histori të njëjtë dhe pse jo edhe guzhinë tradicionale të njëjtë, atëherë le t'i shikojmë këto me syrin vezhgimtar nëse i kemi apo nuk i kemi keto? Nëse bëjmë përpjekje për t'i arritur apo jo? Nëse kemi shpresa për t'i arritur apo jo? Trishtueshem më duhet të citoj një thënie të studiutit Italian Indro Montanelli, kur tipologjizon Shqipërinë në librin e tij "Shqipëria një e njimijë": "Fetarisht të ndarë, politikisht të përçarë, sociologjisht plot kundërshti e mosperputhje, ekonomikisht të rrenuar, e vetmja gjë që i bashkon është deri diku poezia". Me të gjitha këto mospërputhje brenda llojit, duhet ta pranojmë se është mjaft e vështirë për të gatuar një bukë të homogjenizuar në llojshnerinë e vet, e cila t'i përkasë së ardhems tonë të përbashkët dhe të na identifikojë në tryezën e përbashkët evropiane me veçantitë tona.

Historia e popullit tonë, me të vetetë që është mjaft rrëngqethse, e trishtë, heroike, tragjike, prej hirit të heronjëvë të saj lindi edhe kombi ynë, shpeshherë ndëshkuese, shpeshherë frymëzuese, shpeshherë mbush me faj të tjerët dhe shpeshherë mbush me faj edhe ne bijtë e këtij vendi. Nëse, dikur, Sartri thoshte se 'ferri janë të tjerët', vetem pak më vonë doli Jonesko dhe tha 'ferri është brenda nesh'. Në këtë ndërkëmbim thëniesh filozofike dhe problemesh historike të pafundme që ka pasur e vazhdon të ketë nacionaliteti ynë, është shumë e vështirë që njerzit e artit të "vallëzojnë" të çlirtë me zejet e tyre hyjnore që i karakterizon ata, si njerëz të llojit të veçantë dhe vlera kombëtare të patjetersueshme, madje deri aty sa Anatoli Frans ka thënë: Artin e kanë kërcënuar dy përbindësia: Artisti që nuk është artist dhe mjeshtri që nuk është artist. Të gjithë e pranojmë se që nga Homeri i lashtë e duke marrë si shembuj pastaj Gëten, Shekspirin, e shumë të tjerë korifej të letërsisë botërore, e kanë gjetur mbështetjen tek folklori i vendeve të tyre, i cili ka shërbyer si trampolinë për të skeduar vepra të pavdekshme letrare. Po me ne shqiptarët ç'ndodhë? Edhe këtu ka shkrimtarë që janë mbështetur mbi këtë bazament të fortifikuar nga gjeniu –popull. Por ajo që të bie në sy është fakti se as në këtë fushë nuk jemi të njëjtësuar: Madje edhe

vetë brenda kufinjëve të Shqipërisë kemi variante të ndryshme për të njëjtin motiv, le të themi për shembull: në veri kemi Konstandinin e Doruntinën, në jug Konstandinin e Dhoqinën, ndërsa në Kosovë mund të dalin me emra të tjerë. A është trishtuese kur vëmë re, se për faktorë të ndryshëm historik, por më shumë për faktorë të ndryshëm subjektiv, që tregojnë një rezistencë të dobët shpirtërore të vetë nacionalitetit tone, kemi tjetërsim të emrave në fushën e folklorit si nga Mujo-Muji, Ago Ymeri-Ymer Aga, e deri tek Marko Kraljeviqit. E papranueshme do të ishte për çdo nacionalitet të emnacionuar kjo rrokadë marramëndese në tabanin identitar të një populli siç është folklori. Duke cikur edhe pak këtë fushë, vë re edhe një problem tjetër: nëse flasin për tendencë evropianizuese, e para e punës duhet kuptuar se kjo nuk arrihet duke "vrapuar të shaluar mbi shpinën e një kombi tjetër", me këtë dua të theksoj se shumë mite shqiptare, fatkeqësisht, kanë në themel fyerjen e një nacionaliteti tjetër, sidomos atyre që i kemi fqinjë, dhe për këtë e ngre zërin me të madhe studiuesi i madh shqiptar Dr. Profesor Shaban Sinani, deri në atë pikë sa kërkon "krasitjen" e ketyre miteve duke u dhënë atyre ngjyresën e nevojshme nacionale. Në këtë drejtim, jo pak kritik, është edhe Akademik Kapllan Resuli i cili shkon deri aty sa të vëndosë 'pikën mbi i' me emra të përveçëm shkrimtarësh shqiptarë që në veprat e tyre ka një lloj doze që të ngjall urrejtje pandemike ndaj fqinjëve, dhe për këtë do të veçoja veprën monumentale të Njegoshit "Kurora e maleve" e cila në Shqipëri etiketohet e minimizuar në "Kreza e Maleve". Me këto desha të them se arti dhe letërsia e mëdha, askund dhe asnjëherë, nuk kanë qënë të tilla falë mohimit të të tjerëve, dhe kjo nuk duhet të ndodhë as tek ne.

Mundësitë e bashkërendimit në art dhe kulturë midis dy vendeve tona ekzistojnë, dhe janë të mirëfillta në çdo moment, po të bashkohen vullnetet e mira e të çiltra. Ky bashkërendim nuk bëhet me 'heqje dogane' por me përfomancë pozitive dhe perceptim të nevojës për të levizur sa më parë në këtë fushë. Ky bashkërendim duhet t'i marrë shtysat që nga individët e veçantë, grupimet intelektuale, shoqatat etjere, por realizimi i tij duhet bërë nga qeveritë përkatëse të të dyja vendeve, për të cilat nuk mund të kursej asnjë kritikë, të paktën për punën e bërë deri tani. Të gjithë e kemi vënë re se, vetëm këto kohët e fundit, midis dy qeverive tona ka pasur përplasje herë për qumshtin me aflatoksinë, herë për patatet në doganë e herë për miellin. Të gjitha këto krijojnë një ambient të ndotur në bashkëpunimin midis dy vendeve. Atëherë, mund të pyesim vetveten: Këta njerëz qeveritar që zihen mes njëri-tjetrit për gjëra të tilla, a mund të bëjnë shkembime e bashkëpunime kulturore në fushën gjithëpërfshirë të artit? –Unë besoj se jo, bile në këtë aspekt as që e

kanë ngrohur ujin mbi zjarrin thuajse të fikur. Është shumë e papranueshme që në të gjitha tekstet e letërsisë së shkollës 9-vjeçare, ku unë jap edhe mësim, të gjenden vetëm dy-tri poezi të autorve kosovarë dhe thuajse asnjë tregim apo pjesë drammatike, asnjë biografi shkrimtari, asnjë antologji poetike. Në libraritë e vendit tim mund të gjejmë antologji të poezisë spanjolle, amerikane, angleze, ruse, japoneze e deri edhe qipriote, ndërsa është e vështirë, dhe thuajse e pamundur, të gjejmë një antologji të poezisë kosovare. Nderkohë që në të dy qeveritë tona ekziston një ministri e tejfryrë në struktura, që të paktën në vendin tim quhet MKRS (ministria e kulturës, rinisë e sporteve), të cilës është pak t'i thuash: Helm t'u bëftë buka që ha nga ajo karrike! Unë jam i vetëdijshëm se tematika dhe problematika, sidomos në fushën e letërsisë, kanë qënë të ndryshme në vendet tona, por kjo nuk do të thotë se asimilohet mundësia e bashkërendimit kulturor, përkundrazi motivet e tematikat e ndryshme e bëjnë një letërsi më tërheqëse, plot variacion e jetëgjatë. Ja se ç'libra gjej sot në bibliotekën time, me autor kosovar: PRIJËSJA E KOMITEVE" e Sulejman Krasniqit, "RRUGA E SHTEPISE SIME" e Nazmi Sulejmanit, "QENDRESA E EMRIT" si antologji poetike, "E DI NJË FJALË PREJ GURIT" një si antologji poetike, "MIDIS DASHURISË DHE URREJTJES" poezi të Esad Mekullit, "GJAKU IM" poezi nga Qerim Ujkani, "NË VEND TË BIOGRAFISË" poezi nga Agim Vinca, dhe të vetmin liber me tregime kosovare të titulluar "LETRAT DHE GJETHET". I Përmenda këta tituj librash, duke pasë gjithë respektin për to, por edhe për të treguar se të gjitha këto janë botime të viteve tetëdhjetë dhe që nga ai moment heshtja ka mbuluar gjithçka që i përket kësaj fushe. Është një arritje e shkelqyer bashkëpunimi midis shoqatave tona, ku shkembimet e pervojave, shfaqjet e ndërsjellta artistike, evidentimi i vlerave etnografike dypalëshe kanë sjellë një frymë të përbashkët bashkëpunimi dhe njohje vlerash të ndërsjellta, që në fund të fundit kulmojnë në të qenit shqiptar të një geni. Por duhet ta pranojmë të gjithë, se gjeografia e ndikimit të këtyre aktiviteteve është si të thuash provincial, ndaj për këtë duhet ngritë ky lloj bashkëpunimi në shkallë qeverishë midis dy vendeve. Kur është puna për ndonjë analistë politik nga Kosova, herë pas here i vëmë re tek ekranet e televizorëve tanë, por një debat të tillë nuk e kam parë tash njëzet vjet për artin në përgjithsi e letërsinë në veçanti. Kjo është një tegues i papergjishmërisë sipërore nga ata që duhej ta bënin këtë punë. A ka kuptim, që të paktën në këto njëzet vite, të mos zhvillohet një ndeshje futbollit ndermjet dy vendeve tona, një koncert folklorik apo një aktivitet i përbashkët nacional, ndërkohë që politikanët tanë në mënyrë të rëndomt e perdorin kartën e Kosovës për kredo politike, jo vetëm brenda Shq-

ipërisë, por edhe në arenën ndërkom-bëtare. Kjo përbën një turp! Me sa duket politika, për shqiptarët, përbën theksin atraktiv të çdo gjëje, i mbivendoset çdo vlerë, dhe kripë çdo fushë të jetës me zehrin e saj tashmë të shumëprovuar. Si mund ta vlerësojmë, ne shqiptarët, përjashtimin e Akademikut Rexhep Qosja nga Konferenca e akademikëve shqiptarë, që u mbajt në Tiranë me rastin e 100-vëtorit të pavarësisë? Si është e mundur që po kjo vlerë intelektuale shqiptare, në Vlorë shpallet "Qytetar nderi", ndërsa nga këshilli bashkiak në qytetin e Bajram-Currit i mohohet një gjë e tillë? Këto janë veprime që e kanë formën, përmbajtjen, qellimin e domethënien brenda tyre dhe s'është asnjë pikë nevojë për të bërë sqarime të mëtejshme. Miq të dashur, koha ecen përpara, ne segmentojmë veten mbi të, aktojme mbi këtë drejtëz të pafundme duke shërbyer si një hallkë lidhëse nga brezi paraardhës tek brezi pasardhës. Gabimet që bëjmë ne, edhe mund t'ia falim vetes, por e ardhmja do të na denojë, dhe kjo, të jemi të vetëdijshëm se, ka për të ndodhur. Esei i njohur anglez Xhorxh Eliot e perkufizonte kështu kulturën: "Qoftë kur krahasojmë një qytetërim me një tjetër, qoftë kur bëjmë një ballafaqim mes gjendjeve të ndryshme të qytetërimin tonë, duhet të pranojmë se asnjë shoqëri, nuk asnjë periudhë të kësaj shoqërie, nuk realizohen të gjitha vlerat e qytetërimin. Mbase jo të gjitha këto vlera janë të papajtueshme me njëra-tjetrën, por e sigurtë është se tekta pranojmë disa, syresh humbim stinën për të tjerat". Megjithë këto që thashë më lart, unë kam besim se mundësitë e bashkërendimit në letërsi e kulturë ekzistojnë. Ato janë të shumta, por duan një prijë të zellshëm e të vetëdijshëm, të përkushtuar e të aftë... dhe kush mund ta ketë këtë privilegj, detyrim moral e shoqnorë, përveç qeverive tona! Kjo realizohet që nga pasurimi i teksteve shkollore, duke filluar që nga fillorja e deri në universitetet, shkembimi i pervojave pozitive dypalëshe, realizimi i aktiviteteve bashkarishtë e shumë rrugë të tjera të cilat i përfillë vetë koha. Ndarjen tonë 100-vjeçare poeti Agim Vinca e shprehte me tri vargje:

Ka njëqind vjet që s'të kam parë

Nënë, o nënë!

Ka njëqind vjet që s'të kam qarë

Nënë, o nënë!

Ka njëqind vjet që jemi ndarë

Nënë, o nënë!

Tashmë jemi thuajse të bashkuar e barabie mbi ne, mbi ndërgjegjet tona. Po cilat janë ato? Kjo mbetet për t'u parë në të ardhmen, pasi dilemat e ndërgjegjes janë skalitur mjeshtërisht në dy vargje poetike të të ndjërës Ali Podrimja- Sikur ta shikoje ndërgjegjen tënde,

në pasqyrë

do ta puthje,

apo do ta pështyje!?

LAZËR KODRA

PARAQITET LIBRI "ATENTATI QË TRONDITI DY SHTETE"

I STUDIUESIT, POETI DHE PUBLICISTIT PRELË MILANI

Libri "Atentati që tronditi dy shtete" i studiuesit, poetit dhe publicistit Prelë Milani u paraqit, më datë 6 prill 2013 në auditorin e gjimnazit "Dom Bosko" në Shkodër. Veprimtaria promovuese u organizua nga Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" me ndihmësen bujare te anëtarit të kësaj shoqate, Kolë Çardaku. Merrnin pjesë përfaqësues të pushtetit vendor, intelektualë, shkrimtare gazetar të shtypit të shkruar e medieve vizive, studentë dhe banorë nga krahina e Dukagjinit. Aktiviteti filloj me një dokumentar të shkurtër historik me titull "Shala fole e Fatosave të shqiptarizmit".

Në fjalën e tij të hapjes studiuesi publicisti njëkohësisht dhe Sekretarin e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Luigj Shyti i paraqiti një rezymë të përgjithshme rreth librit "Atentati që tronditi dy shtete" i cili rikthe në kohë të pranishmit për të kujtuar se kush ishte Ndokë Gjeloshi. Ky, Veprimtar aktiv politik dhe ushtarak, gardist themeltar i xhandarmërisë shqiptare, i cili gjatë Rrethimit të Shkodrës shpëtoi prej zjarrit Kishën e Madhe dhe civilët që gjendeshin në të. Në kohën e internacionalitetit, që i pari shqiptarë që ngriti flamurin Kambanjelën e Katedrales së Shkodrës. Shkoi në Durrës për t'i dalë zot Princ Vidit dhe për merita ushtarake mori

çmimin "Besa e Bashkimit". Luftoi me Bajram Currin për spastrimin e vendit nga bandat esadiste, që krahu ushtarak i Kongresit të Leshnjës dhe mori pjesë aktive në luftën e Koplikut. Qe anëtarë Komitetin për "Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës". Udhëhoqi propagandën elektorale në favor të Gurakuqit ne vitin 1923. Si politikan opozitar, për krahu kryengritjen e Nolit dhe 10 qershor, duke hyrë i pari në Tiranë në krye të forcave të pararojës së Ushtrisë Kombëtare. Me fitoren e Legalitetit u dënua me vdekje nga regjimi i Zogut, arratiset në Jugosllavi, me pas kthehet dhe vihet ne krye te veprimeve luftarake në Lëvizjen anti-Zogiste te Dukagjinit me 1926. Ne kohen e okupacionit u mobilizua ne milicinë shqiptare dhe mori dekoratën "Senator i Pare". Ndokë Gjeloshi me të shtënat e

rrefeshme mbi mbretin shqiptar në Vjenë hyri në mënyrë spektakolare në Historinë e Shqipërisë, pse jo dhe të Austrisë. Ai ishte dhe mbetet një figure spektako-

të ulët, i kënduar dhe i baltosur, i dashur dhe i urryer, sa i mohuar si heretik aq i paharruar e interesant që më shumë rrezaton se sa nxin.

- Në vijim të aktivitetit u transmetuan pamje filmike, foto dhe dokumente në lidhje me veprimtarinë politike ushtarake të Kolonel Ndokë Gjeloshit dhe te bashkëlufëtarëve te tij Fanolist të varur në litarë të pushkatuar dhe të dënuar nga Ahmet Zogu në vitet 1924-1939 në Shkodër dhe Dukagjin. Aktorja njohur e teatrit "Migjeni" Rajmonda Marku dhe studentet Dorjana Blinishta si dhe Anila Milani sollën mjaft emocion, me leximin e fragmenteve nga ky libër i cili është një histori në sfondin gri e dy armiqve të betuar, Mbreti Ahmet Zogu i Parë dhe Kolonel Ndokë Gjeloshi, Senator i parë. Ky libër, për herë të parë zbulon të dy anët e medaljes se kush ishte Ndokë Gjeloshi? Cilat ishin raportet e tij politike e personale me Ahmet Zogun në kohën kur politika luhej me kobure.

-Dramaturgu shkrimtari publicisti, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja dhe kritik, theksoi se Prelë Milani shquhet për trajtimin e temave të debatueshme, të guximshme si në publicistikë, në gjininë e satirës ashtu dhe në histori. Në këtë monografi autori flet me gjuhën e dokumentit historik te ilustruar me një stil elegant letraropublicistik duke na dhënë një libër që të ngjet, të bën të mendosh thellë, të përfytyrosh dhe përfytyrosh historinë e ngjarjeve dhe personazheve që trajton.

Duke marrë fjalën Prelë Shytani, intelektual dhe aktivist i Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", theksoj "Ky libër është nder për Shalën, Dukagjinin, madje dhe Shkodrën e sotme, është nder për të vlerësuar dhe kontributin e Ndokë Gjeloshit emri i te cilit i baltosur deri dje lidhet me disa ngjarje fatlume me të hidhura me amplitudë tronditëse që mbesin të pashlyera në histori.

Profesor Gjergj Perluca, intelektual i njohur, nënvizoj se libri "Atentati që tronditi dy shtete" është një prurje e re me vlera historike. Atentati i Vjenës ndaj Zogut kishte motive të qarta

politike. Natyrisht si një nga mjetet më ekstreme të luftës politike nuk mund të konsiderohet i pëlqyeshëm, por plotësisht i justifikueshëm dhe ekuivalent me mënyrat spektakolare që ka përdorur Ahmet Zogu pa nguruar kundër të gjithë rivalëve dhe njerëzve që përbenin një rrezik për pozitën e tij sunduese diktatoriale.

Kryetari Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Ndue Sanaj, Kolonel në pension, u shpreh se, njeriu ka brenda engjëllin dhe djallin, prandaj ka ardhur koha që këto personazhe kështu të vlerësohen dhe se Ndokë Gjeloshi në sfondin gri të historisë më shumë rrezaton se sa nxi.


Studiuesi dukagjinasi Kolë Çardaku tha se, Ndokë Gjeloshi e Vas Kiri së bashku me dhjetëra figura të tjera të shquara dukagjinase si Mark Milani, Babun Celi, Zef Delia, Lush Prela, Dedë Thani, Gjelosh Rama, Gjelosh Marku. Kolë Binaku, Prelë Ndoka, Gjelosh Ndoka, Pep Nika, Mark Kola, Kolë Marku përbëjnë mozaikët e lavdisë së Dukagjinit në luftën e tij për liri, demokraci dhe përparim.

Kadri Ujkaj, Kritik letrar duke analizuar raportet politike e personale mes Ahmet Zogut dhe Ndokë Gjeloshit, autori konkludon se: Ngjitja e Zogut drejt Olimp të pushtetit u pasua nga një kalvarë i gjatë, dallaveresh intrigash, ligësishë, heroizmash triumfuese dhe matrapazllëqe të paskrupullta, përmes një rruge gjarpnushë të larë me gjak viktimash e martirësh opozitarë që ishte shkaku i luftës së përgjithshme mes Ndokë Gjeloshit dhe Ahmet Zogut.

Publicisti dhe kryeredaktori i Gazetës "Dukagjini", Lazer Kodra u shpreh se, dikush, sidomos njerëzit e brezit të moçëm komunist dhe zogist, të mësuar t'i vlerësojnë ngjarjet sipas kultit të tyre ideologjik të vjetër, mund edhe ta gjykojnë si herezi, dikush tjetër në mos plotësisht realist e të pa anshëm, do ta konsiderojnë këtë libër më së paku një risi për historinë e dy armiqve të betuar në sfondin gri. Këshilli i komunës Shale, për kontribute te veçanta, Kolonel Ndoke Gjeloshit i ka dhënë titullin "Qytetar Nderi" i komunës Shale, pas vdekjes. Ndue Ndreza, kryetari i këtij këshilli, me rastin e promovimit të këtij libri, në emër të këshillit, pasi lexoi vendimin, titullin ia dorëzoi te afërmit te kolonel Ndoke Gjeloshit, Kole Nikes.

Me marrjen e këtij titulli, Kolë Nika falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë promovim, Falënderoi studiuesin Prelë Milani që shkroi një copëz të historisë së pa ndriçuar të Dukagjinit në përgjithësi dhe Ndokë Gjeloshit në veçanti.

Nga Dukate Bregu



U NDA NGA JETA LUFTËTARI I LIRISË SHEUQET (SHEKO) MUSHANI



Me datën 19 mars 2013, u nda familjes së tij të dashur, të afërmeve, të veteraneve të LANÇ të rrethit Shkodër, Sheuqet (Sheko) Mushani.

Sheuqet Sadik Mushani lindi në Tuzit, me 20 mars 1923, në një familje me tradita atdhetare. I tille ishte edhe biri i kësaj familje, Shekoja në gjithë jetën e tij derisa u nda nga ajo.

Me vdekjen e nënës së tij, e cila e la shume të vogël, ai rritet e shkollohet nen kujdesin e hallës, që jetonte në qytetin e vogël, të Rjekës. Aty, përfundoj shkollën fillore dhe me vone dërgohet për të vijuar shkollën e

mesme në qytetin e Shkupit.

Në vitin 1941 vjen në Shkodër, pranë babait, vëllait dhe motrës, të cilët kishin ardhur kohe më pare. Këtu, bie në kontakt menjëherë me të rinj antifashist e revolucionar të lagjes "Perash". Në këtë kohe, Shekoja, punonte me një përkushtim të madh në shërbim të LANÇ, në shtëpinë e të cilit strehoheshin ilegale të shumte të luftës dhe zhvilloheshin mbledhje të rëndësishme për situatën e kohës. Nga marsi i vitit 1943, aktivizohet shume në njësitin gueril të qytetit duke marre pjese në disa aksione të guximshme antifashiste. Merre pjese në tërheqjen e armatimeve të renda e municioneve nga "Ana e malit", duke i sjellë në bazat e luftës së qytetit. Në mesin e qershorit 1943, rreshtohet me arme në dore në Çetën e dyte Partizane dhe më vone në përbërje të batalionit "Perlat Rexhepi". Atij i ngarkohet detyra e vështirë, por e rëndësishme për shoqërimin e një kompanie

të ushtrisë së vjetër shqiptare të dezertuar nga Ulqini për t'iu bashkuar batalionit "Perlat Rexhepi", e cila mori pjese në luftën e Reçit, me 31 gusht-1 shtator 1943, kundër forcave të armatosura fashiste italiane. Në këtë beteje heroike e fitimtare të partizaneve, Sheko Mushani u shqua për guxim e trimëri të radhe.

Me datën 1 nëntor 1943, Shekoja caktohet së bashku me 120 partizane të tjerë të shkoje në Malësinë e Tropojës dhe në Kosove, për të zgjeruar LANÇ në ato zona dhe për ngritjen e këshillave NÇI. Gjate marshimit tejet të vështirë dhe me plote të papritura drejt Alpeve dhe qëndrimin në ato zona, Sheko Mushani u shqua për moral të larte e përkushtim të madh atdhetar.

Më vone, si pasoje e të ftohtit të egër e qëndrimin të gjate në dëborën e madhe, Sheko Mushani sëmuret dhe së bashku me disa shoke dërgohet në

një baze lufte në qytetin e Gjakovës për t'u shëruar. Dy dite më vone, baza spiunohet, rrethohet e partizanet kapen në befasi. Pas arrestimit, Sheko Mushanin, me shoke e dërgojnë në burgun e Prizrenit. Nazistet gjermane e marrin të lidhur nëpër qytet duke e publikuar në popull si një kriminel. Në burgun e Prizrenit qëndron rreth një muaj, por kaloi tortura nga më çnjerëzoret dhe megjithatë qëndron, por e transferojnë në kampin e Prishtinës. Prej aty e largojnë së bashku me rreth 300 antinaziste të tjerë, me tren i çojnë drejt Austrisë, në Vjene. Në kampin e përqendrimit të Vjenës, në fshatin e Brajterfurgut, Sheko Mushani përjetoi ditët më të renda të jetës së tij. Ishin goditjet vdekjeprurëse të Ushtrisë së Kuqe, të Ushtrisë Sovjetike, që iu dha ushtrisë naziste në lindje, qe çliroi Vjenën dhe të gjithë të burgosurit e kampeve atje. Kështu, në maj të vitit 1945, Sheko Mushani kthehet në atdhe.

Pas çlirimit të vendit nga pushtuesit nazifashist e bashkëpunëtorët e tyre, Shekoja u ngarkua me detyra të rëndësishme, si: Shef i seksionit të

shëndetësisë dhe z/prokuror i rrethit në Shkodër. Kreu specializime në fushën juridike në Tirane dhe në Bashkimin Sovjetik Nga vitit 1966 dhe deri në vitin 1984, vit që doli në pension, punoi pranë Ministrisë së Transporteve, në detyrën e kryetarit të degës së kontrollit e të shfrytëzimit të automjeteve për zonën e Veriut të Shqipërisë.

Pas daljes në pension, Shekoja aktivizohet në Organizatën e Veteraneve, në të cilën ka punuar në mënyrë të shkëlqyer. Sheko Mushani, deri sa u nda nga jeta ishte Anëtar Nderi i Komitetit të veteraneve të rrethit Shkodër; ndërsa Komiteti i Veteraneve në nivel Republike i ka dhenë titullin e larte "Nderi i Organizatës". Për merita të shquara në lufte dhe në pune është nderuar me dekorata e medalje të ndryshme.

Ndarja nga jeta e këtij luftëtari të madh të lirisë, qe një humbje e madhe jo vetëm për familjen e tij të dashur e të nderuar, por edhe për të gjithë veteranet e pasardhësit e veteranit, me të cilët punoi shume për forcimin e organizatës sonë.

Nga Vehbi Fishta,
Kryetari i Komitetit te Veteraneve te rrethit Shkodër.

JETE E HUMBUN

Autori i këtyre kujtimeve Ejëll Çoba (1908-1979), u lind dhe u edukua në gjirin e një familjeje të njohur, të fisme dhe patriotike të qytetit të Shkodrës. Pas mësimeve fillore në vendlindje, vijoi për 13 vjet rresht jashtë shteti, në Itali, formimin dhe arsimimin e mëtejshëm, të cilin e kurorëzoi shkëlqyeshëm me çertifikimin "Dottore in Giurisprudenza" pranë Universitetit prestigjioz "La Sapienza" të Romës. Më pas i kthyer në atdhe ndoqi karrierën profesionale dhe politike, duke demonstruar një karakter të fortë prej njeriu ihtar të ligjit dhe të së drejtës. Për këto u vlerësua dhe u çmua në ato kohë nga aktorët më të rëndësishëm të jetës politike dhe shoqërore të vendit. Me ardhjen e komunizmit Ejëll Çoba përfundoi në burg. Këtë libër kujtimesh ai e shkroi në kohën e diktaturës, në vitet (1973-1978), pas daljes nga burgu.

Në parathënien e tij studiuesi Rrok Ndoja shprehet: "Në libër të lënë mbresë mendime dhe mentalitete, analiza dhe sin-teza të sakta, prognoza për ngjarje dhe zhvillime që koha i ka vërtetuar, ku shfaqet kapaciteti dhe klasi i një njeriu të ditur, objektiv, të hapur, të emancipuar dhe i një politikani të mprehtë.

Ndeshen gjithashtu edhe fakte të reja për personazhe të veçanta të jetës politike dhe shoqërore të pas Luftës së Parë Botërore. Të gjitha këto shtillen me një stil komunikues, të drejtpërdrejtë, por edhe me nëntekste, mjaft të kursyer pa fraza të gjata që të mërzhisin. Shumë vlera të tjera lexuesi do t'i konstatojë vetë përgjatë e deri sa t'u shkojë në fund këtyre kujtimeve".

Aktorët e teatrit "Migjeni" Rita Gjeka, Jozef Shiroka, si dhe Megi Topalli sollën mjaft emocion, me leximin e fragmenteve nga ky libër kujtimesh.

Studiuesi dhe kritiku Agron Tufa theksoi se gjuha e autorit, rrëfimi dhe përshkrimi janë në gegërishten letrare, ndërsa një pjesë e dialogëve janë lënë në toskërisht, kjo të bën të mendosh se gjuha është në mënyrë simbolike një mjet rezistence ndaj pushtetit të hetuesve, si forcë e papajtueshme. "Faqet e këtij libri, - vuri në dukje Tufa -, ngrënë lart ndjenjën e krenarisë sonë historike, dinjitetin tonë njerëzor, origjinën tonë".

Duke marrë fjalën Agim Musta, ish i përndjekur politik, u shpreh se shumica e të dënuarve në burgjet komuniste ishin nga Shkodra. "Ky është nder për Shkodrën e sotme, është nder për të gjithë ata që kanë vuajtur në burgje dhe kampe. Duke lexuar kujtimet e Ejllit më erdhën në mend shumë personazhe të terrorit komunist".

Bashkëvuajtësi i autorit, in-

tektuali i njohur, Amik Kasaruho e kujton Ejëll Çobën dhe të vëllanë Kelin për qëndrimin e tyre dinjitoz. "Ata së bashku

me dhjetëra figura të tjera të shquara përbëjnë mozaikët e lavdisë të kombit tonë, ndaj unë do të thoja që kjo nuk është

"jetë e humbun", përfundoi Kasaruho.

Merkur Babameto tregoi ngjarje emocionuese nga jeta në burg; ndërsa Mërgim Korça kujtoi aktivitetin human të Ejëll Çobës si personalitet politik, sidomos në shpëtimin e disa familje hebrejsh gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Kryetarja e Parlamentit Shqiptar, Jozefina Topalli përcolli me shumë emocion ligjëratat e bashkëvuajtësve të Ejëll Çobës. Pasi falënderoi të gjithë të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë promovim, ajo vijoi: "Unë kam pasur fatin të jetoj dhjetë vjet me autorin e këtij libri, Ejëll Çobën. Nuk e fsheh që e kam adhuruar. Kujtoj kur ulej në tavolinë lexonte shumë dhe shkruante, por unë nuk e dija çfarë shkruante. Më vonë fillova ta merrja me mend ... Ai shkroi një copëz të historisë së shqiptarëve. Për mua ai ishte një engjëll".

Arjeta Ferlhukaj



BASHKË MUND TË BËJMË MË SHUME

Me datën 19-20 prill 2013, një përfaqësi e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" e përbërë nga kryetari i Shoqatës, Ndue Sanaj; sekretari i shoqatës Luigj Shyti, kryeredaktori i gazetës "Dukagjini", Lazer Kodra; kryetari i seksionit të veprimtarive të shoqatës, Prele Milani, kryetarja e seksionit të kulturës, Roza Pjetri, anëtarët e kryesisë: Aleks Dushi dhe Anton Kosteri; anëtare të shoqatës: Silvana Arrinaj e Diana Bungu; aktiviste të shoqatës Lulash Brigja, Tomi Delija, Xhozefa Bungu dhe Damjana Arrinaj dhe i mirënjohuri koreografi Aldo Nika me grupin e valleve prej 7 çiftesh, ishte në Kosovë dhe mori pjesë në Manifestimin "Zëri Vëllazërimit-2013", të organizuar nga Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me qendër në Pejë.

Manifestimi u realizua me sloganin "Bashkë mund të bëjmë më shumë!".

Në këtë Manifestim morën pjesë:

- * Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", në Pejë,

- * Shoqata "Atdhetare-Dukagjini"- Shkodër,

- * Ansambli "Majat e Karafilave" – Plavë e Guci,

- * Ansambli "Shpëtimi" në Medvegje,

- * Këngëtarë, valltarë, shkrimtarë e veprimtarë nga Hoti, Gruda, Koja e Trieshi- Malësi e Madhe,

- * Ansambli "Selman Sadria", Istog

- * Shkrimtarë, artistë e veprimtarë nga Shqipëria, qytetet e Kosovës dhe nga zonat e tjera shqiptare,

- * Ansamble e këngëtarë nga Peja, Istogu, Klina, Deçani e qytete të tjera.

Manifestimi filloi në Pejë, me Tryezën Tematike, me teme: "Bashkë mund të bëjmë më shumë", në të cilën ligjëruan: Sekretari i Shoqatës "Martin Dreshaj", Frasher Raca, veprimtaret Neim Prelvukaj e Anton Lulgjuraj; ndërsa nga ne ligjëruan: Lazer Kodra, me teme: "Mundësitë që bashkërisht të bashkëpunojmë në letërsi e art" dhe Luigj Shyti, me teme: "Bashkë mund të bëjmë më shumë". Pastaj u nisem për në komunën e Istogut, në të cilën na priti N/kryetari i komunës Agim Ademaj dhe autoritet të tjera të komunës. Pas një shëtitje neper

qytet nën muzikën e valleve tradicionale, në veçanti nga grupi i valleve "Majat e Karafilave" të Plavës-Guci dhe grupi i valleve të koreografit Aldo Nika, u ndaluan para pallatit të kulturës së kësaj komune. Në oborrin e këtij pallati para qindra e qindra qytetareve të komunës së Istogut

u dha një koncert me kënge e valle nga përfaqësuesit e trojeve të Shqipërisë së Vjetër, në veçanti me këngëtarin e mirënjohur Ismet Demaj, grupi valleve "Majat e Karafilave", grupi valleve të Aldo Nikes. Gupi i jone u paraqite me vallen e T' Lekve dhe me vallen sipas motiveve Tiranës, të

cilat u mire dhe u duartrokiten nga pjesëmarrësit.

Pas një darke të shtruar nga kryetari i kësaj komune Haki Rugova, u mbyll dita e pare e manifestimit.

Në ditën e dytë të manifestimit, në ora 10.00 ishim në komunën e Klinës, në të cilën na priti N/kryetari i kësaj komune Zenun Zeqa, Pas vendosjes së luleve të freskëta në monumentet e dëshmoreve të Luftës për Çlirimin e Kosovës dhe në monumentin e Nenës Terezë, u bë lëvizja neper rrugët kryesore të qytetit me valle tradicionale dhe nën muzikën e tyre.

Në orën 11.00 filloi veprimtaria "Fjala poetike", apo ora e poeteve. Për këtë, anëtarët e kryesisë Aleks Dushi, me interpretuesit anëtarët e shoqatës, Djana Bungu, aktorin Tomi Delija, nxënëset Xhozefa Bungu dhe Damjana Arrinaj, solli para pjesëmarrësve poetet e mëdhenj Martin Camaj,

Ali Pordrima, Azem Shkreli e At' Viçenc Malaj, të përgatitur me mjaft përkushtim dhe të paraqitur nëpërmjet monitorit dhe recituesve apo interpretuesve Tomi, Djana, Xhozefa e Damjana.

Me përfundimin e këtij spektakli, u njohëm dhe dëgjua disa poet të komunës së Klinës.



Pastaj, nen shoqërimin e N/ kryetarit të komunës hëngrëm dreke dhe pas një përshëndetje vëllazërore dhe të urimit "ju presim përsëri", u nisem për në Glllogjan.

Në Glllogjan, pranë varreve të dëshmoreve, na priti Baca Halim, babai i heronjve të Luftës në Kosove, babai i Ramush Haradinaj. Ai, pas vizitës që bëmë në varrezat e dëshmoreve, na prit në shtëpinë e tij me kafe dhe një gote raki. Aty, në emër të kryesisë së Shoqatës, Bacës Halim, ju dorëzua Medaljoni i Shoqatës sonë për djalin e Tij, Ramush Haradinaj, me motivacion: "Për kontributin e jashtëzakonshëm të dhënë në Luftën pa kompromise për Çlirimin e Kosovës. Një personalitet i veçantë e vlerave njerëzore e nacionale. Heroi i Pathyeshëm në shërbim të nacionalitet shqiptar; Lider në luftën për emancipimin e shoqërisë kosovare drejt standarteteve euroatlantike".

Duke marre me vete mbresat e jashtëzakonshme të këtij Bace që Luftës në Kosove i kishte dhënë tre djem, tre dëshmore, tre heroi, u nisem për në Deçan, në qendrën e Rrafshit të Dukagjinit. Aty na priti kryetari i organizatës së veteraneve të Luftës së Kosovës, kolonel Mushkolaj, i cili në emër të kryetarit të Komunës, Rasim Selmanaj na uroj mirëseardhjen dhe na shoqëroj në një darke të shtruar në shenje respekti për miqtë. Pas darke, na takojë dhe bëmë foto me kryetarin e komunës, Rasimin.

Në orën 19. 00 u nisem për në Shkodër dhe mbërritëm në orën 23.00, në saj të përkushtimit e përgjegjësisë mjaft të larte të shoferit tone, Zyhdë Lekaj.

Në këtë pjesëmarrje, në kuadrin e 10 vjetorit të krijimit të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe 5 vjetorit të bashkëpunimit tone me Shoqatën e Vëllazërisë Kosove-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj", me vendim të kryesisë nr. 998, date 15 prill 2013, ju dorëzua titullin "Mirënjohja": poetit Azem Shkreli e Ali Podrima; veprimtareve: Frashër Raca e Ismet Demaj, Drejtorisë së kulturës në Kline, intelektualet Drita Krasniqi, këngëtarit e rapsodit Dervish Shaqë (pas vdekjes), ansambllit "Selman Sadria" në Istog, ansambllit "Majat e Karafilave" në Plavë e Guci, ansambllit "Shpëtimi" në Medvegje; ju dorëzua titullin "Anëtar Nderi" të Shoqatës veprimtareve: Anton Lulgjuraj, Neim Prelvukaj, poetit Prend Buzhala, studentes Qëndresa Jashari dhe



kolonel Avdyl Mushkolaj.

Kryesia e Shoqatës "Martin Dreshaj", nderoj me titullin "Anëtar Nderi" të kësaj shoqate, Ndue Sanaj, Roza Pjetri dhe Aleks Dushi.

Përfundime:

1-Falënderojme punën e bere nga Lulig Shyti e Lazer Kodra në përgatitjen e temave dhe që ligjëruan me mjaft kompetence në tryezën tematike. Falëndero-

jme punën e palodhur dhe cilësisht të Aleks Dushit, që përgatiti dhe prezantoi para pjesëmarrësve në komunën e Klinës, me grupin e recituesve në veprimtarinë "Fjala poetike", për krijimtarinë e poeteve Martin Camaj, Ali Podrima, At' Vinçenc Malaj e Azem Shkreli.

2-Pjesëmarrja në manifestimin "Zëri vëllazërim-it-2013", nuk mund të realizohej pa ndihmën financiare të komunës Pult, me kryetar Sokol Cubin; e konsullit të Nderit të republikës së Austrisë në Shkodër dhe N/kryetar të Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini", Gjergj Leqejza; të anëtarit të këshillit të bashkisë së qytetit Shkodër, anëtarit të kryesisë së Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini" dhe biznesmenit Mhill Prioni; si dhe të anëtarit të Shoqatës sonë, Zef Gjergj Nika. Këtyre nuk ju kane tepruar të ardhurat financiare, por atdhetarizmi i tyre nuk i lejon të mos kontribuojnë për të pas prezent vlerat e Dukagjinit e dukagjinave në çdo mjedis atdhetar, në

çdo mjedis të hapësirës shqiptare se, vetëm në këtë mënyrë bëjmë të mundur njohjen tone, njohje e vlerave të trashëguara dhe përpjekjet që bëhen për tu emancipuar drejt standardeve euroatlantike. Prandaj i uroj me urimin popullor: "Zoti i'ua shtoftë! Paçin e dhënçin!" Me këtë rast ju bëjmë thirrje biznesmenëve dhe tregtareve dukagjinave dhe më gjere, bëni përpjekje që nga të ardhurat tuaja financiare të na ndihmoni që të vijojmë të realizojmë më mire misionin e shoqatës se, pranë nesh do të gjeni në çdo kohe vetëveten. Duhet të dini se, punohet në mënyrë vullnetare! Kjo është e rëndësishme dhe një element më shume që tu nxit për më shume në kontributin tuaj.

3-Këshillave të komunave të Dukagjinit, kryetareve të tyre, ju bëjmë thirrje: Të bëjnë përpjekje të bëhen në çdo rast pjesë e Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini". Kjo thirrje, vjen nga eksperiencia e komunës së Pultit apo ndonje tjetër në mes veti, por dhe nga eksperiencia e shkëlqyer e komunave të Kosovës dhe në veçanti të atyre të Rrafshit të Dukagjinit, të cilat në çdo rast janë pjesë e manifestimit "Zëri Vëllazërim-it" brenda hapësirës së tyre.

4- Shoqata, kohet e fundit po mbushet me gjak të ri, çka tregon se po ecet në rrugë të drejte. Por, shoqata ka nevojë të mbushet më me shume gjak të ri, në veçanti me nivel të larte arsimor se, ata janë më me pak komplekse dhe kane më shume vizion për të ecur përpara, për të ndikuar më shume në emancipimin shoqëror, për të realizuar më mire misionin e Saj.

Shoqata "Atdhetare-Dukagjini" me përpjekje te vijueshme e ka treguar veten që i ka shërbyer dhe i shërben Dukagjini tone, prandaj ajo duhet të jetoje, dhe që të jetoje duhet të mbushet me të rinj e të reja se, vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet ecja e saj.

5- Anëtarëve të kryesisë dhe gjithë anëtarësisë së Shoqatës i bëhet thirrje, të bëjnë përpjekje të vlerësojnë me shume punën që bëhet, të respektojnë punën e secilit, larg mentaliteteve të "unit", larg mentaliteteve nihiliste se, ato nuk na çojnë në asnjë përfundim pozitiv. Përkundrazi, ato na pengojnë të realizojmë misionin e shoqatës, çka nuk është e drejte të pengohemi në realizimin e tij. Askush nuk mund të "ngrejë" me shume se mundet, por ajo që bëhet të vlerësohet se, nuk është bërë vetëm dhe as nuk mund të vijohet e të bëhet vetëm. Gjithçka e bërë deri tani është kontribut i të gjithëve. Kjo është e rëndësishme të kuptohet drejte se, ende kemi shume pune për të bërë në realizimin e misionit të shoqatës. Përpara kemi DHJETEVJETORIN e krijimit te shoqatës sonë, festimi i se cilës është detyrim moral dhe kontribut për secilin nga ne.

Nga Ndue Sanaj,
Silvana Arrinaj

Pozicioni i Republikës Parlamentare në Shqipëri



Romeo Gurakuqi
Instituti i Historisë Bashkëkohore
Universiteti European i Tiranës

Republika e dytë parlamentare shqiptare e tranzicionit është në një krizë të rëndë. Tatëpjeten e Republikës, në pik-pamje të ruajtjes së parametrave të të qenurit Shtet, mund ta shpëtojë frenimi i rënies së matutjeshme, përmes reformimit të institucioneve kushtetuese dhe skemës institucionale.

Në fakt, nuk është për t'u befusuar, por goditjet që iu dhanë sistemit parlamentar, (edhe ashtu jo i përplotësuar, të krijuar nga kushtetuta e vitit 1998), në vitin 2008, prodhuan zbalancim institucional, zbazësira procedurale, transformizëm politik të paprincipitë, mungesë mbrojtjeje edhe formale të lirive civile përmes dobësisë të pavarësisë dhe profesionalizmit të institucioneve të ruajtjes së rendit e të ligjit, pasiguri rrënuese në funksionimin e shtetit ligjor dhe në mbrojtjen e jetës së qytetarëve, dobësim deri në minimumin historik të përgjegjësisë publike dhe të përgjegjësisë ndaj Respublica-s dhe në fund, edhe në kapje të segmenteve të caktuara. Sot, brenda këtij vendi, në jetën aktive politike, nuk ekziston një kastë politike e aftë të prodhojë, së paku, 10 wise man within the Parliament, që të kuptojnë jo vetëm shembjen që po ndodh para syve tanë dhe të rindërtojë skemen institucionale të shpëtimit, por që edhe të gëzojë besimin masiv të publikut, me burrinë e shtetarëve të vertetë.

Ajo që po ndodh këto tre ditët e fundit është vetëm rrjedhë logjike e të gjithë historisë se këtyre viteve në politikën shqiptare, pasojë e informalizimit të jetës politike, në një shkëmbim të mirëfilltë material, pasojë e klientelizimit të segmenteve të politikës në një periudhë relativisht të gjatë të 22 viteve tranzicioni. Nuk është për t'u çuditur, që transformizmi i para tre ditëve të riciklohet shumë shpejt në ditët në vijim, si shenjë e prishjes së ekuilibrave brenda Parësisë tiranase.

Në një vend normal me demokraci liberale parlamentare nuk mund të ndodhë asnjëherë që një pjesë e koalicionit qeveritar të pranohet nga opozita në radhët e veta, 83 ditë para zgjedhjeve të caktuara. Nuk di ndonjë rast që një pjesë e koalicionit e shkëputur dhe e drejtuar në prehrin e një opozite mjaft të vendosur, të hamendësojë se mund ta votojë serish qeverinë, apo edhe të abstenojë, të mbajë përfaqësuesit e vet në administratën lokale, dhe të emëruar në administratën e lartë qeveritare. Nuk ndodh që të supozohet opsioni i shmangies së votëbesimit

parlamentar të qeverisë kur koalicioni tronditet. Nga ana tjetër, të pretendosh se nepërmjet transformizmit do të synosh maksimalizmin e fitores, do të thotë se ke thënë një sofizëm të kulluar, i cili nuk fsheh dot etjen për rimarrje me çdo kusht e çmim, pa marrë parasysh idealet dhe nevojat e Publikut.

Në qoftë se gjërat do të funksionojnë kështu, me normalitet në dukje, do të na duhet të pranojmë se Republika Parlamentare është formalizuar e për rrjedhojë po shkon drejt rënies, në kushtet e këtij kadri konstitucional.

Kjo sepse, kësaj Republike i mungojnë procedurat ose rregullat zakonore konstitucionale për të sistemuar, mbi të drejtën, raste të tilla të çuditshme alla shqiptare; i mungon e drejta procedurale e krijimit të një qeverie të fortë teknicienësh të paanshëm tranzicioni politik që garanton paanshëri; sistemit nuk i funksionon më përfaqësimi i përputhshëm i elektoratit, i shprehur në orientimet e përcaktuara nga partitë politike në momentin e votimit; llogaridhënia qeverisë ndaj parlamentit ka ardhur duke u fikur (formalizuar) (accountability of the government to parliament); pozicionimet normale pozitë-opozitë janë deformuar nga interesat e padukshme; balancat institucionale janë shtrembëruar frikshëm; ndërrimi i pakthyeshmëri i elitave në pushtet e pavarura është shndërruar në një këmbim rotativ; transformizmi politik në një zakon të përsëritur që nuk bën asnjë çudi. Ndërkaq, roli institucional i Presidentit të Republikës si Kreu i Shtetit, në vend që të vinte duke u përforcuar dhe të bëhej një institucion mbizotëruar mbi palët, të bëhej korrektiv dhe kryesues i zgjidhjeve politike (parliamentary system with a presidential corrective), sikurse ndodh në kontekstin bashkëkohor parlamentar të vendeve post-komuniste, është dobësuar e thjeshtëzuar deri në përmasa të pangjashme me çdo vend parlamentar të shekullit XXI (parliamentary system with figurehead president).

Në periudhën pas rënies së Murit të Berlinit, sistemet parlamentare janë korigjuar, jo duke forcuar Ekzekutivin dhe duke bërë ate jo kolegial, moskokëçarës dhe më pak të përgjegjshëm dhe të shpjegueshmëri, por duke bërë të kundërtën: duke rritur përgjegjshmërinë, shpjegueshmërinë e transparencën ndaj Sovranit dhe Publikut, duke forcuar balancën e pushteteve, ndarjen dhe kontrollin reciprok, duke forcuar rolin e Presidentit të Republikës Parlamentare në mbizotërim mbi Palët, në korrektim, në udhëheqjen e zgjidhjes së konflikteve politike, në leadershipin politik të vendit në aspektin e politikave të sigurisë dhe në marrëdhëniet me jashtë, në mbrojtje e padallim të interesave të Publikut. Në Shqipëri, në vend që të ecej në prirjen e sistemeve bashkëkohore institucionale të Republikave Parlamentare, duke forcuar indikacionet e mësipërme, është bërë e kundërta: sistemet kontrolluese dhe balancuese mes institucioneve janë dobësuar, boshllëqet ligjore themeltare janë zgjeruar, zgjedhjet mbeten gjithnjë problematike, e të tjera. Nga ana tjetër,

sistemi zgjedhor proporcional, që në një vend parlamentar normal, krijon qeverisje parlamentare me spikatje të Asamblesë përfaqësuese, në Shqipëri ka krijuar në mënyrë paradoksale një reaksion të kundërt: ka çuar në mënyrë të zhdrejtë në spikatje të Ekzekutivit. Ligji zgjedhor në vend që të krijonte një përfaqësim adekuat të bashkësive të qytetarëve shqiptarë, qendrueshmëri politike përmes votimit njëemëror mazhoritar, që eliminon rolin e partizave personale, familjare e klienteliste, ka çuar në shmangie të nevojave të një vendi që deshiron stabilitet, duke prodhuar transformizëm elektoral, si ky që na u riciklua këto ditë, jo befasisht dhe që nuk do të ndalet këtu.

Opozitat në vendet parlamentare kanë ardhur në pushtet duke u mbështetur mbi një kauzë të caktuar politike, mbi një ripërtëritje të burimeve humane politike dhe intelektuale (siç bëri saktësisht me shumë të drejtë, PD në vitin 2005), dhe jo duke u mbështetur në transformizmin e një segmenti të rëndësishëm të pushtetit, me anën e një martese politike të paparimtë.

Zakonisht, spektaklet të tilla transformuese politike janë rrjedhojë e foshnjërisë dhe e dobësisë së institucioneve, e amortizimit të sistemit elektoral, qasjes korrupsioniste të partive politike, e në rastin e Shqipërisë, edhe të një inskenimi uniteti në prapaskene që mund të vijë, si nga ish falangat e Diktaturës, ashtu edhe nga konsorciumet monopoliste (Mafio-kracia emërtohet në literaturë). Ajo që ndodhi këto ditë më ngjan të jetë një sponsorizim më së shumti i ithtarëve të Hoxhizmit dhe i konsorciumeve të ndër-lidhura me një mije fije të padukshme.

Të humburit e mëdhenj të gjithë kësaj që po ndodh do të jenë qytetarët e thjeshtë shqiptarë që do vazhdojnë të vuajnë paqendrueshmërinë politike dhe mungesën e ripërtëritjes ekonomike; do të jenë forcat liberal-demokrate (qoftë edhe brenda Partisë Socialiste, që nën Rilindje edhe besuan për ripërtëritje të parametrave të Shtetit), që aspirojnë një Shqipëri Europiane; e djathta tradicionale shqiptare, elektorati që nuk pa një ditë të mirë nën regjimin komunist dhe që nuk u kompensua asnjëherë në mënyrë adekuate nga shteti i tranzicionit, bijtë e familjeve që u vranë, u burgosën, u internuan dhe u dëbuan nga shtëpitë dhe vatrat familjare dhe sot mbeten të papërfaqësuar, të harruar, të denigruar e të nëpërkambun. Kjo, sepse kostoja e martesës politike me partitë e majta me tradicion komunist është e tillë. Kjo sepse zhvendosja në gjirin e opozitës që doli me flamur liberal, e të njejtës, përveç vryshkjes që i sjell menjëherë pjesës idealiste të veprimtarisë opozitare, do t'i përcjellë linjës politike të saj, edhe inatet provinciale ndaj kulturës perëndimore, ndaj liberal-demokracisë tradicionale, botës qytetare shqiptare dhe do mbart veçanërisht paragjykimin e mirënjohur të kësaj pjesë të Zonës së Parë Operative, ndaj Shqipërisë Veriperëndimore. Shkrirja kësisoj, do të dobësojë qasjet e njimendta europianizuese dhe perëndimuzuese, të linjës së politikës socialiste

shqiptare, duke vonuar edhe në të ardhmen proceset integruese.

Por, kjo është Shqipëria e postkomunizmit: e ngërthyer nga fantazmat e tij të "reformuara", nga një botë e padukshme që luan lojtarët e politikës së përditshme në kahun e dobësisë të Shtetit.

Sot sistemi parlamentar me ngjan të jetë në rënie të lirë, drejt të panjohurës, në qoftë se mbi këtë sistem nuk vendoset dorë për ta korrigjuar në ADN e vet, në Kushtetutë. Korrektimi mund të ndodhë si brenda kuadrit të Republikës Parlamentare, duke e bërë atë me të vertetë Republikë të një parliamentary system with a presidential corrective, ashtu edhe duke transformuar Republikën tonë drejt një parliamentary with president.

Pra, Republika jonë mund të mbetet parlamentare, por të bëhet më shumë funksionale, në aspektin e rritjes së rolit të institucioneve kontrolluese, balancuese dhe drejtuese, në aspektin e krijimit të një qeverie shumë më të shpjegueshme në planin praktik dhe në ngritjen deri në përmasat udhërrëfyese e korrektuese të rolit të Kreut të Shtetit, që pikërisht për këtë arsye më të lartë funksionale, mund të zgjidhet drejtpërdrejtë nga populli.

Shqipëria ka nevojë për një ndërhyrje në sistemin zgjedhor për ta bërë atë më përfaqësues, por edhe më produktiv, në aspektin e prodhimit të qendrueshmërisë dhe shmangies së transformizmit politik të paprincipitë dhe gjithëpërfaqësimit të elektoratit dhe bashkësive të veçanta të shtetasve shqiptarë.

Shqipëria ka nevojë për një ndërhyrje fort mirë të studiuar në forcimin e laicitetit dhe shekullarizmit, që të rregullojë jo vetëm aspektet e brendshme të sjelljes politike në përgjithësi, të sjelljes së politikanëve brenda në institucionet shtetërore, por edhe ato të marrëdhënieve me jashtë.

Ndër hapat e parë që mund të ndërmerren në legjislaturen e ardhshme do të duhet të jetë ndryshimi i ligjit mbi partitë politike, në të gjithë aspektet, ligj që duhet t'i shndërrojë ato në koalicione të mëdha interesash programore nacionale. Kjo sepse historia politike në një vend demokratik, është histori e elektorateve dhe e përzgjedhjeve të tyre të lira, dhe jo fryt i vendimeve imponuese personale, i politikave transformative, deformuese të individeve që drejtojnë forcat politike, siç po ngjan me dhimbje në ditët tona. Një demokraci zgjedhore është në thelb një Shtet me konkurim të partive politike, me zgjedhje të lira konkurrenciale dhe me ndarje të pushteteve midis degëve të ndryshme të qeverisë, një shtet që mbron plotësisht të drejtat e liritë civile universale dhe imponon shtetin e së drejtës dhe barazinë e qytetarëve para ligjit. Një mision i tillë nuk mund të jetë funksional, pa demokratizimin e partive politike shqiptare dhe pa ngritjen e nivelit të tyre të ekspertizës profesionale.

Shqipëria jonë ngjan të jetë ende larg asaj çfarë pret qytetari i thjeshtë i këtij vendi, ngjan të jetë ende larg prirjeve rregulluese institucionale të vendeve europiane post-komuniste, madje edhe në kah të kundërt me ato.

INTEGRIMI, PROBLEM EKONOMIK E SOCIAL I SHTRUAR PËR ZGJIDHJE

Me integrim kuptojmë përfshirjen tërësisht në jetën e komunitetit ku jetojmë apo ku do shkojmë, është aspirata jone për tu integruar në Evropën e Bashkuar.

Rruga për tu integruar në Evropë nuk kalon nga Azia apo Amerika, ajo është etu dhe në jemi pjesë gjeografikisht dhe historikisht edhe si popull i vogël i kemi kontributet.

Luftërat e popullit shqiptar kundër Perandorisë Osmane ishin pengese për marshimin e hordhive turke drejt Evropës Perëndimore dhe me të drejte Gjergj Kastrioti është konsideruar nga historianet "Mbrotjtës i qytetërimit Evropian". Gjithashtu dhe rilindësit tanë dhe pas vendosjes së Pavarësisë dhe gjate Luftës së Dytë Botërore e me pas populli ynë ka ruajtur lidhjet me Evropën derisa ne me hapjen e Shqipërisë me shume se një milion shqiptar emigruan në Evropë dhe ajo i punësoi i strehoi dhe dha ndihma për Shqipërinë. Tani shtohet problemi i integritimit në Evropë, por është e rëndësishme integrimi i brendshëm në mes veti i shqiptareve. Për këtë kërkohet një pune cilësore për zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë, ngritjen e shtetit juridik-ligjor dhe shtetin e drejtës, rritja e nivelit të jetesës së popullit, i të ardhurave për frymë për të arritur mesataren e vendeve Evropiane, si dhe emancipimin e mëtejshëm të shoqërisë. Për tu integruar kërkohet që ne të mendojmë si evropianet e qytetëruar e demokrat. Megjithatë ka njëzetë e ca vite që ne Shqipëri është vendosur pluralizmi, vazhdon një demokraci e brishtë e formale, ku ende fjala e lire dhe mendimi ndryshe

nuk kanë gjetur mirëkuptimin, ndaj edhe mendimi, dialogu konstruktiv, konsensusi e kompromisi, mbartësit e mendimit ndryshe nuk konsiderohen kundërshtar, por sipas konceptit të vjetër, si armiq dhe këto e kanë çuar shpesh në acarime sociale. Duhet të kemi parasysh se në kemi qene afro pesë shekujve nën robërinë e Perandorisë Osmane aziatike e prapambetur në ekonomi dhe në kulturë, ajo ka lanë koncepte me pasoja në psikologjinë e popullit tone, të cilat fatkeqësisht ekzistojnë edhe tani, edhe në metodat e sjelljes së politikaneve tanë. Duhet punë për tu çliruar nga ato arkaizma. Këto janë reflektuar gjate kësaj periudhe të tranzicionit të tejzgatur, të cilën vende të mëdha e kanë kaluar me shpejt dhe tani janë në normalitet. Gjithashtu për tu integruar kërkohet të punojmë, sepse puna, - thotë Adam Smithi, ekonomisti i madh anglez, i cili konsiderohet si babai i kapitalizmit-është baze e prodhimeve të mirave materiale dhe burimi i çdo pasurie. Gjate kësaj periudhe tranzicioni, ku baza ekonomike e sistemit monist nuk u transformua, por u shkatërrua dhe kështu vazhdoi zhvillimi i kapitalizmit të egër, korruptim, në të cilin dominoi puna e zeze. Pasurimi brenda kësaj kohe të shkurtër nuk i përket kapitalizmit.

Rrok Feleri i kish filluar kursimet që kur ishte në shkollën fillore, me parat e vezëve të pulave dhe pastaj me punë e talenti, u bë me pasuri i botes. Kapitalizmi, në saj të organizimit të punës ka vënë në lëvizje energjitë mendore dhe fizike, dhe nëpërmjet kësaj ka krijuar shpirtin praktik të punës, arritje e madhe në krahasim me pararendësit e tjerë. Nëpërmes

kësaj ka arritur rezultate të niveleve të larta në prodhimin e të mirave materiale, përparimin e shkencës e të teknikes. Dihet që kapitalizmi udhëhiqet nga filozofia pragmatiste, e cila ka në qendër të vëmendjes fitimin maksimal dhe për arrijtjen e këtij qëllimi justifikon çdo mjet. Kjo ka bërë që të lindin disa fenomene të dëmshme për shoqërinë, si: krimi, korupsioni (kryesisht të politikanet pushtetarë), prostitucioni, trafikimi i qenieve njerëzore, i armeve, i drogës e të tjera. Fenomene këto që kanë ndikuar dhe dëmtuar shoqërinë tone, këto kanë dëmtuar imazhin e demokracisë dhe ka pasur pasoja tek njerëzit tanë, të cilët vuajnë edhe sot dënime edhe atje ko vepron shteti ligjor. Tek ne, si mungese e shtetit ligjor vazhdon koncepti i mos ndëshkimit të keqbërësve e sidomos të politikaneve pushtetarë të inkriminuar. Kjo, për pasoje ka sjellë pakënaqësinë e popullit, mungesën e mosbesimit tek institucionet e shtetit. Gjithashtu jemi bërë objekt i kritikave ndërnacionale.

Integrimi arrihet me punë konkrete dhe jo me fjale bombastike dhe eufori e duke u matur me mesataren dhe jo me majat e botes. Duke menduar e punuar si evropianet krijohen edhe konceptet për të jetuar si evropianet. Kjo kërkohet një emancipim progresiv të shoqërisë sonë, për klasën politike, në veçanti për ata që janë në pushtet. Kërkohet që të zbatohen liget dhe përpara tyre të jenë të gjithë të barabartë, sepse vetëm kështu vendoset demokracia.

Shqipëria i ka të gjitha kushtet materiale e njerëzore për t'u bashkuar me Evropën e qytetëruar dhe demokratike.

Natyrë është treguar bujare me ne dhe për rrjedhojë ka rezerva, të cilat Evropa do të dije të shfrytëzojë! Ajo do ta ndihmojë Shqipërinë të përfitojë nga integrimi. Megjithatë magjia nuk vjen, por duhet që vetë shqiptaret dhe politikanet të punojnë për zhvillimin e përparimin e vendit. Këtu, integrimi i brendshëm ka rëndësi të madhe dhe njerëzit që kanë lëvizur gjate kësaj periudhe tranzicioni drejt fushave e qyteteve duhet të punojnë për tu integruar me dinjitet aty ku banojnë. Shkodra është një qytet që natyrë i ka dhuruar shume të mira dhe ka njerëz me dije, me kulture, prandaj me të drejte quhet "Djepi i Kulturës Shqiptare". Shkodra ka pasur lidhje të vjetra tregtare, kulturore, martesore me shume vende të Evropës. Një rol pozitiv e me vlere ka luajtur kleri katolik nëpërmes hapjes së shkollave, të teatrit, të sportit e lidhjeve të tjera kulturore që i shërbejnë edhe integritit tone në Evropë. Në këtë kuptim, banoret e rinj ndihen këtu mire, bëjnë një jete të këndshme dhe duhet të integrohen në kulturën dhe edukatën e këtij qyteti të lashtë me tradita kulturore e historike, se vetëm kështu do arrihet që të integrohemi në Evropën e qytetëruar dhe demokratike.

Sigurisht integrimi kërkohet kohe që mund të shkojë dy-tre breza në komunitetin ku banon, ndërsa në Evropë shumica e qytetarëve shkodrane janë të evropianizuar dhe Shqipëria se shpejt përfshihet në Evropën e Bashkuar.

Nga Pjeter Delija

Si të shmangjet Stress-i e Ankthi?



DR. Med. Ndue Nikaj, Bushat

Nuk është e lehtë të mposhtet stress-i e ankthi. Megjithatë mund të jenë të vlefshme disa këshilla si më poshtë :

Stresi-i paraqitet me dhimbje kokë, sy të skuqur, prerje barku, rrahje zemre, me ankth-mërzi të përditëshme, humor të zymtë, pra i mërzitur, i vetmuar etj.

Ja disa këshilla:

Përqendrohuni në punën (detyrën) tuaj. Në vend që të bëni shumë gjera

njëherazi përqendrohuni në detyrën tuaj dhe mos u merrni me punë të tjera pa përfunduar atë. Kështu çdo punë do të hajë më pak kohë dhe ju padyshim do ndiheni më i çlodhur dhe më i kënaqur nga puna që bëni.

Bëni një pushim për të mos u marrur me lajme. Një ditë në javë bojkotoni lajmet, mos ndiqni radio, televizion; mos lexo gazeta. Në se ka ndonjë gjë të madhe ju do të jeni shumë më mirë pa e ditur. Gjatë një dite ju do të kurseni për organizmin tuaj stress-in pak a shumë koshient pa u varur nga lajmet.

Vendosuni (bieni) në qetësi. Shumë ndërmarrje sigurisht kanë rregulluar menaxhimin në vende të qeta ku punonjësit mund të kalojnë disa çaste larg zhurmave të kompjuterave, të printerave, të makinave, të telefonave dhe të nuancave të tjera zanore.

Merrni pushime . Kur nuk ndjeheni mirë kërkoni të merrni pushimet tuaja sa të merrni vehten dhe të relaksoheni. Ditët e pushimit janë të nevojshme për

të mbetur aktiv dhe menaxhoni zemren tuaj. Pra planifikoni mirë pushimet në mënyrë që të ktheheni në formë të plotë.

Mund të adoptoni një kafshë shoqëruese (sidomos femrat). Një studim i realizuar në Kinë, Gjermani dhe Australi ka vlerësuar se përonat që shoqërohen me kafshë : si qen, mace etj; shumë pak shkojnë tek mjeku për vizitë, kanë më pak probleme gjumi dhe marrin pak ilaçe për zemër. Përdorni objekte antistress për të lehtësuar jetën e përditshme; për të qetsuar mendjen; për të ulur lodhjen si objekte prej gome në imazh të bretkosës, peshk, zogj, që shtypen në dorë dhe lëshojnë tinguj ose dritë me ngjyrë ose erna relaksuese.

Merrni frymë thellë. Kur gjendeni në një gjendje stress-i bëni provë pas një pauze-pushimi-merrni frymë ngadalë dhe thellë 4-5 herë rresht (rradhazi).

Dëgjoni muzikë. Është vërtetë se kur në operacionet e vogla me anestezi lokale (me mpirje) përonat që dëgjojnë muzikën e preferuar gjatë ndërhyrjes operative janë më pak anksioz dhe kanë më pak lëkundje tencionit dhe të ritmit të zemrës krahasuar me ato që nuk dëgjojnë muzikë.

Bëni masazh. Kur ju jeni në tencion, muskujt tuaj janë të tkurrur fort, gjë që pakëson qarkullimin e gjakut dhe ardhjen

e oksigjenit. Një masazh bën që të relaksohen muskujt, ky mund të kryhet nga vetë përoni (automasazh) me një top tenisi i cili rrotullohet aty ku ndihen tendosje si qafe, shpatulla; kavilje a shputën e këmbës. Mund të përdorni "Yoga" disa ushtrime shtëpie ku ndihmon në rritjen e mirëqenies mendore e fizike.

Përdoret "Schiatssu". Masazh me presion me bulat e gishtave në pika të ndryshme, si koke, fytyrë në gjymtyrë, në kyçin e dorës, gjë që pakëson stress-in dhe ankthin, ul shqetsimet, dhimbjet;

Hani darkë heret. Të paktën 2 orë para se të bini për të fjetur, merrni qumësht, djath, kos që kanë Triptofan që kthehet në Melatonin (ndihmon gjumin), mund të merrni Çokolatë se ka Magnez që është relaksues i fortë dhe antistress dhe së bashku me fenylalaninën janë antidepresiv. Provoni të fleni mjaftueshëm deri 8 orë, për këtë mund të përdorni dhe ilaç-bimor si bar blete, kamomile, valerjana, dhe së fundi dhe gjumë sjellsit e ti : Zopidem, Triazolam ose lomerthazepam që nuk janë benzodiazepina dhe nuk krijojnë varsi, por duhet të përdoren nën këshillat e mjekut.

Qani. Duhet të shpërthejë vaji kur ndjehet, lotët largojnë lëndët kimike të dëmshme që krijohen në organizëm gjatë stress-it dhe dobësonn energjit në gative.

Në Michigan festohet 102 Vjetori i Flamurit në Deçiq



Zef PERGEGA

Me 2 prill 1978 ne Detroit te SHBA përkujtohet për here te pare Kryengritja e Malësisë se Madhe dhe legjenda e flamurit tone nacional Dedë Gjo'luli, i cili me 6 prill 1911 ngriti simbolin e Kastriotit ne Bratille dhe me një çete prej 18 vetash ia nisi luftës, për çlirimin e tokave shqiptare te okupuara nga e sëmura e Bosforit.

Një grup patriotesh e nacionalistesh malësore te besimit katolik dhe mysli-

man, ne mes te cilëve spikasin emrat e veprimtareve Llesh Grishaj, Prof Prek Gruda, Prel Martini, Lek Ivezaj, Gjergj Hasanaj, Zef Kolcaj ... zgjodhën kryetar Bajram Çunmulaj dhe folës te rastit Prel Zefi Lulgjuraj.

Për 35 vjet me radhe malësoret e kane kthyer ne tradite ketë date historike, e cila ne faqen e patriotizmit shqiptar është e shënuar me germa te arta. Lu-menjtë burojnë nga veriu dhe nga mali e marrin forcën te rrjedhin drejt detit. Kështu ne mënyre figurative i ngjanë ajo çete e fiseve malësore qe u bene bashke ta pastrojnë vendin nga pushtuesit dhe ti kthejnë atyre lirinë.

Shoqata atdhetare "Malësia e Madhe" nen drejtimin e Pashko Gjokaj ne bashkëpunim me këshillin e kishës se Shën Palit organizuan ne ambientet e këtij kulti fetar te 35-te feste te kryengritjes se Malësisë se Madhe, ku morën pjese rreth 800 bashkatdhetar nga te gjitha krahinat. Ky aktivitet u drejtua nga Ndue Gjokaj dhe

e reja Eliza Lulgjuraj. Ne fjalën e hapjes, Gjokaj, i cili e drejtoi ne mënyre profesionale aktivitetin, nder te tjera tha: "Ne emër te shoqatës atdhetare "Malësia e Madhe" dhe këshillit te kishës se Shën Palit ju uroj nga zemra mirëseardhjen ne përkujtimin e 102 vjetorit te kryengritjes se Malësisë se Madhe, kësaj date te shënuar ne altarin e nacionalitetit tone, ku trimat e trimëshat e udhëhequr nga Ded Gjon Luli pas 500 vjet robëri i thane botes mbare se jemi zot te truallit shqiptar. Para pak kohesh festuam 100 vjetorin e Pavarësisë se Shqipërisë, ngjarje kjo qe i parapriu Memorandumit i Greces se Trieshit ose Libri i Kuq, me kërkesat e malësoreve drejtuar kancelarive evropiane dhe aktin e madh te flijimit për lirinë e atdheut i te gjithë familjes te heroit tone nacional Ded Gjon Lulit. Ne, si mërgimtar do ti kultivojmë dhe do ti trashëgojmë e vlerat me te mira te atdhedashurisë dhe kulturës për te mbetur shqiptar edhe ne boten e lire...!"

Folësi i rastit, Leke Camaj nga Tuzi i Malësisë se Madhe evokoi ne mënyre shkencore, bazuar ne dokumente historike jehonën e kësaj kryengritje brenda dhe jashtë vendit duke tronditur nga themeli Perandorinë Osmane.

Takimin e përshëndeten dhe vlerësuan dhe Kryetaret e Qyteteve; Shelby TWP dhe Sterling HTS.

Takimin e përshëndeten Dom Ndue Gjergji dhe Dom Fran Kola. Përshëndetja e ambasadorit tone ne Uashington, Gilbert Galanxhi u prit me interes te madh për nga mesazhi qe ajo përcillte tek populli ynë. Ai kishte marre me vete edhe diplomate e ambasadës tone. Morën fjalën edhe Prof. Lulash Palushaj, kryetari i Vatrës Gjon Bucaj-zv/ministri dhe kryetar e Ballit, dhe Rok Dokaj.

Grupi i valleve i drejtuar nga Paparito dhe këngëtarët virtuoz te komunitetit Hana e Kole Nikprelaj i dhanë festes ngjyrimet e pathosit atdhetar.

Përshendetë Kryetari i Shoqatës "Dukagjini" Michigan, Nikolin Shyti

Të dashur vëllezër dhe motra! Bashkatdhetar të mi, kudo që të ndodheni, brenda dhe jashtë kufijve të atdheut tonë të sh-trenjtë!

Në emrin tim dhe të Shoqatës "Dukagjini" ju uroj të gjithë besimtarëve katolik dhe ortodoks "Gëzuar Pashkët" dhe ditën e Ringjalljes së Krishtit.

Qoftë kjo ditë paqe, harmonie dhe bashkimi për popullin shqiptar kudo që të ndodhet e në veçanti do ti uroj popullit të Malësisë së Madhe atje ku u linda dhe u rrita, ku u shkollova e u edukova, ku kapërceva të mirën dhe të keqen gjithmonë me ndihmën e tyre dhe të familjes time në Kamicë të Malësisë së Madhe.

Një urim të veçantë dua të rezervoi për gjithë popullin e Dukagjinit kudo që të jetë, në atdhe e nëpër botë i mërguar dhe urimin special popullit të Thethit të Dukagjinit e në veçanti Gjelajve të Thethit të Dukagjinit.

Nuk mund të rri pa i uruar gjithë dukagjinasve që jetojnë dhe punojnë në SHBA e veçanërisht këtu në Miçigan se, sot jemi të gjithë bashke si gjak i një familje.

Gëzuar! Gëzuar! Gëzuar!

Paqe, Paqe, Paqe dhe bashkim ashtu si na ka hije gjithëve bashke dhe i ftoj gjithë shqiptaret në ketë ditë të madhe të Pashkëve t'ia shtrijmë dorën njëri-tjetrit e ti themi me plot zemrën: ME SHENDET PASHKET!

Edhe një herë ju uroj PAQE, BASHKIM E DASHURI, RESPEKT PER NJARI-TJETRIN GJITHË SHQIPTAREVE PA PERJASHTIM!

URIME! URIME! URIME!



GJUHA PA FRENA E LAGJES SIME

Nga Vullnet Mato

Lagjja ime rome me këngë e valle ritmike, ka dhe gjuhë të shkathët e të pasur me spica. Femra për gjoksin e saj merr lëvdatën tipike: "Sa të bukur e paske mi, të raftë ujku në cica!"

Burrat lakmojnë me oreks bukurinë zezake: "O mi të hangsha lapën e syrit për meze! Eja mi rrospi, të puth një herë lala në faqe, se me zjarr furrnalte trupin ma ndeze!"

Gratë ia shprehin xhelozinë njëra-tjetrës, me sharje ku burrat e tyre falin dhuratë: "O mi të shtriftë burri im ke pragu i derës, moj by ... tenxhere me llapën sa një lopatë!"

Pijanecët e dehur ngacmohen pas darke: "Ku je, mre barkalec nandë muajsh me barrë, që ke përta tanë fuçitë e birrave në mejhane, dhe ke hanger mish macesh të pjekme në zgarë".

Djemtë u hedhin romuze vajzave çokollatë: "Eja, mi goce, bajmë qejf sonte për voni, mos e ço atë derr trupi haram përnatë, tuj ba naze, sikur je e bija e Klintonit!..."

Kjo gjuhë pa frena dhe pa hunj në gardh, që i fluturon batutat në lagje si lakuriq nate, më bën të ndjehem rom me lëkurë të bardhë, dhe të hap sy e vesh, për qyfyret në pallate... Gazeta "Tribuna shqiptare", date 26 prill 2013

METEORI GURAKUQ

Mik i miqve, besë e burrnisë Ideator i madh i atdhedashurisë Inisiator për pavarësinë shqiptare Flamur-lartë i lirisë kombëtare

Njeriu me shpirtë të bardhë U nis drejt Vlores, ashtu valë-valë Popullin e vet e kish në zemër Nuk deshi as nam, as t'bjë emër

Hedhë synin nga deti poet Gurakuqi Nishani n'sy asnjëherë s'i huqi Bashkë ma historinë po priste Qemalin Të ishin bashkë si mali me malin

Veç një qellim e bani me durue E nder kushtime kurrë s'u ligstue Shkëmbi- Luigj me ato mustaqe E mbante Shqiperinë si ura me harqe

Vargje që vijnë si tallaze prej detit Janë fjalët e shpirtit, fjalë të poetit Janë të gjalla në çdo përvjetor Bien një nga një yjet, jo ky meteor.

JHONA GUSHI,
SHKOLLA E MESME
"LUIGJ GURAKUQI",
KLINË-KOSOVË

Referendumi - akt antikonstitucional

Pasi që pushtetit aktual në nivel qëndror iu dha edhe mbështetja politike për të bërë "çfarë të dojë", nga partitë politike "shqiptare" në territorin e Malësisë, vjen radha e miratimit të akteve "ligjore" për të vënë në pikëpyetje fatin dhe të ardhmen e Malësisë së Madhe. Fjala është për mbajtjen e "referendumi konsultativ" për Komunën e Malësisë. Akt që do të na kushtojë rëndë! Në kohën kur laicizmi politik dhe juridik ka arritur majën e ajsbergut në Malësi, përgatiten "lojëra" që do të dëmtojnë pozitën e shqiptarëve në këtë trevë. Rënja e qetësisë absolute, heshtja e tepruar, tentativa për të dëmtuar harmoninë fetare nga ana e pushtetit, plaçkitja e pronave, frika në masë galomane, diskriminimi në bazë të etnisë (mos përfaqësimi në organet shtetërore), distancimi nga premtimet parazgjedhore të politikanëve që sot janë me Qeverinë, papunësia në skajet më të larta, varfëria në masë, mungesa e perspektivës, mungesa e planeve vizionare për të ndërtuar një të ardhme më të mirë, mos organizimi i shoqatave për mbrojtjen e të drejtave tona, maskilizmi i tepruar duke treguar që jemi mbrapa në kohë për të patur aspiratat që gjoja i kemi tani duke muar gruan si shtyllë e shoqërisë, pozita e vështirë e banorëve në zonat malore, kanë bërë që qytetarët e Malësisë të "kënaqen" me këtë "kafshatë" që kanë!

Për të disatën herë, deklaroj publikisht se jam dhe do jem kundër "referendumi konsultativ" sepse bjen ndesh me parimet dhe vlerat e të drejtave fundamentale dhe demokratike të Evropës në të cilën jetojmë. Këto të sanksionuara në Konstitucionin e Malit të Zi, në Konventën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ka filluar viteve të fundit të flitet se do bëhet një "referendum". Njëherë u tha se do bëhet në 2008! Pastaj u tha se do bëhet në 2011! Pastaj u tha se do bëhet në prill të 2013! Më në fund thuhet që do bëhet deri në shtator të 2013! E kush e din se kur do bëhet, por kjo ka pak rëndësi, sepse për ata, e rëndësishme është që do bëhet! Këto lojëra, të sajuara për të demoralizuar dhe për të turbulluar mendjen e qytetarëve të Malësisë, me keqardhje e them që ia kanë arritur qëllimit!

Në fillim (në vitin 2008), një grup i këshilltarëve në pushtetin e Komunës Urbane të Tuzit, atëbotë ishte dakord që të bëhej referendumi, por njerëz të filtruar e kundërshtonin! Pas pak kohe, të njëjtit njerëz ishin kundër referendumi. Ndërsa në muajt e fundit të vitit të kaluar, asnjë nga këshilltarët në kuvendin e KU të Tuzit (e kam fjalën për përfaqësuesit shqiptar), nuk ishte kundër këtij akti, gjoja "demokratik" për themelimin e vetëqeverisjes lokale. Pra, siç e shihni dhe e dini edhe ju vetë, brenda 4 viteve, "përfaqësuesit" tanë kanë ndryshuar qëndrim 360°! Kjo tregon paditurinë, mungesën e një platforme, përjashtimin e bashkëpunimit me faktor kompetentë,



mos sinqeritetin për elektoratin, mashtrimin në masë, keqpërdorimin e besimit!

E shoh të nevojshme që të bëj një shpjegim në lidhje me aktin më denigrues që shqiptarët në trevën e Malësisë do të përballen në muajt në vijim.

Referendumi është instituti më i përhapur dhe më i rëndësishëm i demokracisë si rezultat i sovranitetit të popullit. Fjala referendum rrjedh nga latinishtja që dmth: "për të cilin duhet informuar". Referendumi është institut i të drejtës ndërkombëtare publike, që shërben për: ndarjen dhe bashkimin e shteteve duke formuar konfederatën ose federatën. Referendumi është edhe institut i të drejtës Konstitucionale, që shërben për miratimin e ligjeve të ndryshme, të cilat mund të sjellin ndryshime rrënjësore në shtetin përkatës, ose miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ose anëtarësimin në një nga organizatat ndërkombëtare. Në referendum, zakonisht, zgjedhësit përcaktohen për njërin nga alternativat PRO ose KUNDËR.

Klasifikimi i formave të referendumi bëhet në bazë të faktorëve të ndryshëm siç janë:

- Baza juridike për mbajtjen e referendumi;
- Obligueshmëria e vendimit nga referendumi;
- Efekti i vendimit nga referendumi;
- Çështja për të cilën vendoset me referendum;
- Koha e zbatimit të referendumi.

Për nga baza juridike dallojmë dy lloje të referendumi:

- 1-Referendumi i detyrueshëm dhe
- 2-Referendumi konsultativ ose këshilldhënës;

Do trajtoj vetëm referendumin konsultativ, me qenë se ai ka të bëjë me kauzen tonë, në mënyrë që edhe ju ta keni një ide më të qartë se me çfarë kemi të bëjmë.

Referendumi konsultativ ose këshilldhënës: është ajo formë e të vendosurit të drejtëpërdrejtë të zgjedhësve, në të cilin akti që është objekt i referendumi nuk miratohet, por përmes referendumi vetëm shpreh mendimin rreth tij. Ky përkufizim, na tregon qartë se objekti në referendumin konsultativ (që do të jetë "jeni pro apo kundër Komunës së Malësisë"), edhe nëse votohet me shumicë PRO, nuk ka asnjë detyrim Qeveria që të respektojë mendimin e sovranit, nga vetë fakti që thjesht merret vetëm një mendim (opinion). Ky lloj referendumi, zhvillohet në kufij të përcaktuar të territorit të Malësisë nga ana e pushtetit qëndror dhe jashtë vullnetit të qytetarëve të Malësisë dhe për të duhet të shprehen edhe pjesa e popullsisë me origjinë jo – shqiptare. Pra, votohet edhe aty ku ka pësuar ndryshim demografik popullata vendase autotktonë. Votimi i kësaj pjese populare me origjinë jo – shqiptare mund të sjellë humbjen e statusit të Komunës së Malësisë dhe të sjellë në pikëpyetje fatin e popullit autotkton!

Këtë projekt të pushtetit qëndror e

vlerësojmë si kurth për të pastruar popullin autotkton shqiptar në territorin e Malësisë! Ne duam të bashkëjetojmë me të gjithë qytetarët e Malësisë, qofshin këta shqiptar apo jo, por duhet që për fatin tonë të shprehet vetëm populli autotkton shqiptar sepse duhet cilësuar si pasuri shtetërore siç e përkufizon Konventa Ndërkombëtare për Popujt Autotkton dhe Fisnorë.

Duke qenë se referendumi është i ideuar nga Partia në pushtet së bashku me satelitët e saj, në terma të përgjithshëm paraqet këtë situat:

-Referendumin do ta shpallin kur ata të vlerësojnë se "e kanë situatën nën kontroll". Më këtë dua të them që nëse zhvillohet referendumi, partia në pushtet e ka të parashikuar rezultat.

-Rasti i dytë është, nëse në mënyrë hipotetike, Malësia me shumicë shprehet PRO Komunës së Malësisë, përsëri kjo nuk është e garantuar, sepse politikisht i është dhënë mundësia që pas përmblyes së referendumi, të jetë përsëri pushteti ekzekutiv ai që do vendosë për fatin e Komunës së Malësisë. Por, duke qenë se vullnetin e tyre e njohim shumë mirë prej dekadash, Ne e dijme se cili do jetë qëndrimi i tyre.

-Nuk do të zhvillohet në të gjithë territorin e Malësisë së Madhe. Kjo tregon që Plani është që disa pjesë si Kojë, Korita, Poprati, Rakiqi, Vrellat, Kakarriqi, Omerbozhajt etj, mos të votojnë (shprehen) për Komunën e Malësisë!

-Nëse i referohemi klasifikimit të formave të referendumi të cituara më lartë, vërejmë në pika të shkurtra: baza juridike është e hartuar nga komisione përkatëse në organe shtetërore me dirigjenca thellësisht politike, duke shkelur minimalisht katër akte juridike që në hierarki do të ishin: Konventa ndërkombëtare për popujt autotkton dhe fisnor; Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut; Konventa Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, Konstitucioni i Malit të Zi. Nëse i referohemi obligueshmërisë, vërejmë që edhe nëse bëhet referendumi, rezultati i tij nuk është i obliguar për tu respektuar. Kjo lehtëson arsyetimin e Malit të Zi përpara faktorit ndërkombëtar. Nëse i referohemi efektit të vendimit nga referendumi; ai është plotësisht negativ për këto arsye:

1-Nëse nuk kalon referendumi për Komunë, atëherë i hapen rrugët pushtetit që të veprojnë politikisht mbi territorin e Malësisë së Madhe duke përfunduar aktin e ndryshimit të strukturës së popullsisë, të plaçkisin pronat, mos të zhvillojnë infrastrukturën, mos të zhvillojnë ekonominë, të rrisin papunësinë, të krijojnë kushtet për "dëbim kolektiv" etj;

2-Edhe nëse referendumi kalon me shumicë votash që Malësia ta ketë Komunën, nuk është i detyruar pushteti Ekzekutiv që ta zbatojë. (shiko më lartë përkufizimin e referendumi konsultativ);

3-Cënohet parimi i sigurisë juridike. Kjo do të thotë që edhe pse shumica e Malësisë (për aq sa u jepet mundësia) mund të shprehet me referendum, mos zbatimi nga ana e qeverisë e vullnetit të votuesëve tregon mos funksionim të

shtetit të së drejtës dhe parimit të sigurisë juridike;

4-Cënohet e drejta e votës për të gjithë qytetarët e Malësisë! Ky është edhe një aspekt tjetër për ta trajtuar "referendumin konsultativ" si akt anti-konstitucional!

5-Efekti negativ i referendumi, nëse në mënyrë hipotetike nuk kalon, atëherë Pushteti ka gjithë fuqinë dhe legjitimitetin për të sjellë vendim që mos të themelohet Komuna e Malësisë, sepse vullneti i popullit ka qenë KUNDËR Komunës, etj.

-Nëse i referohemi aspektit kohë: shohim që është plotësisht në duart e qeverisë për të vendosur edhe për datën se kur do të mbahet referendumi. Kjo tregon mos seriozitet dhe lojë të ndyrë me qytetarët e Malësisë. Është kulmi i poshtëritimit dhe degradimit të qytetarëve.

Dua të sqaroj edhe mënyrat e fitimit të Komunës së Malësisë pa "referendum konsultativ":

Të eliminohet "referendumi konsultativ" me vendim të Gjykatës Konstitucionale dhe kjo e fundit të detyrojë Qeverinë të respektojë instrumentat ligjorë të brendshëm dhe ndërkombëtar.

2- Me Vendim të Këshillit të Ministrave të Malit të Zi të vendoset që pa asnjë hezitim, pa asnjë zvarritje të mëtutjeshme, të themelohet Komuna e Malësisë.

3-Tirana dhe Prishtina zyrtare, të kërkojnë me këmbëngulje që Malësisë ti jepet Komuna pa asnjë kusht. Si hap i parë duhet që përfaqësuesit tanë politik në Parlamentin e MZ-së dhe në Kuvendin e KU-së të japin dorëheqjen dhe të kërkojnë ndërmjetësimin e Tiranës, Prishtinës, Ambasadës së SHBA-së dhe Ambasadës së BE-së.

4- Të merren në shqyrtim elaboratet e hartuara nga FDI-ja dhe në bazë të tyre të themelohet Komuna e Malësisë. Ne kundërshtojmë rreptësisht hartimin e elaborateve të tjera (që po flitet ditët e fundit se do jenë përsëri), sepse pas elaboratit tonë për Fizibilitetin e Themeimit të Komunës së Malësisë qëndrojnë shumë ekspertë, si të brendshëm ashtu edhe të jashtëm!

5- Të themelohet një grup nga Malësia në bashkëpunim me trojet e tjera shqiptare në Mal të Zi dhe të fillojnë punën për të realizuar këtë ideal në mënyrat e cituara më lartë.

Partitë politike që iu bashkangjiten PDS – së, është dashur që këtë ligj ta godasin në Gjykatën Konstitucionale të Malit të Zi për antikonstitucionalizmin e tij. Fatkeqësisht, ekzistojnë dyshime tek organet e drejtësisë që edhe po të go-ditej ky akt në Gjykatën Konstitucionale, kjo e fundit do ta linte në fuqi, por nuk kemi të drejtë të paragjykojmë. Në lidhje me këtë të fundit, dua ta përmbledh me një citim të Gjyqtarit të shquar Britanik Lord Bingham i cili ka thënë që: "më të vërtetë ekzistojnë vende ku gjykatat dhe gjyqtarët ishin dakord me qeverinë. Por këto nuk ishin vende ku shumica prej nesh dëshironte të jetonte".

Nga Iur. Anton Lulquraj,
Kryetar i Forumit
Demokratik për Integrim

INTELEKTUALËT ARBËRESHË DHE FIGURA E TERENC TOÇIT

Nga Domenik Kasiano,
arbëresh

Me 21 deri me 24 prill u mbajt në Napoli një kongres tjetër gjuhësor, promotor i të cilit ishte Kozmo Serembe prej Shën Kozmos, President i Shoqërisë "Shqipëria e Re". Edhe ky Kongres nuk arriti asnjë rezultat konkret. Vendimet e tij qenë kundërshtuar nga Terenc Toçi për paqartësinë dhe pamjaftueshmërinë në sensin politik. "Kongreset, -shkruese Toçi, duhet të jenë para së gjithash politike dhe nuk kanë nevojë për patronat të lartë, por t'i bëjnë thirrje besnikërisë dhe fisnikërisë së popullit, jo qeveritarëve dhe diplomacisë, sepse diplomacia dhe tirania janë sinonime. Një gazetar i njohur i epokës, Ugo Ojetti, në korespondencën e tij nga Shqipëria ka shfaqur mendim se shoqëritë dhe veprat e arbëreshëve kanë luajtur rol të rëndësishëm në kritikën e disa theksimeve, të cilave u mungonte realizmi politik dhe ishin pak të dobishme, jo më shumë se ushtrimi retorik i njerëzve të fshatit.

Një kongres tjetër u mbajt në Napoli, në qershor të vitit 1903, me synimin për t'i bashkuar italo-shqiptarët, që të ndihmonin në Pavarësinë dhe zhvillimin e Shqipërisë. Kongresi u mbajt nën përkujdesjen e Riçioti Garibaldi-t, personit që kishte mundur "sipas programit të Mazinit dhe të Garibaldit", të kryente organizimin e rinisë italo-shqiptare dhe ta mbante gati për çdo rast, në bazë të së drejtës nacionale qoftë të Italisë, qoftë të popujve ballkanikë. Kjo ide e njohjes politike dhe interesave të përbashkëta në mes të Italisë dhe Shqipërisë do të ishte linja udhëheqëse e lëvizjes arbëreshe për Pavarësinë e Shqipërisë. Asaj i mungonte realizmi, pasi politika italiane e pas viteve tetëqind, kishte projekte të tjera të ekspansionit dhe të sundimit në bregun tjetër të Adriatikut.

Garibaldit iu besua kryesimi i "Këshillit Shqiptar të Italisë", me programin e vetëm politik, fitimin e Pavarësisë së Shqipërisë. Por, edhe kësaj radhe, pa ndonjë rezultat praktik. "Shqipëria, -ka vërejtur Xhovani Laviola, - për shumë njerëz përfaqësonte një tokë të idealizuar dhe të ëndërruar, duke krijuar një motiv të përlëshjes me fjalë, por që asnjë palë nuk mendonte për të luftuar. Ai që quhej "Dheu Mëmë", duhej ta fitonte me mjete të tjera pavarësinë.

Një apel naiv për "marrëveshje" midis Italisë dhe Shqipërisë

Në një periudhë të lindjes së nacionalizmit, kur Ballkani u bë teatër i përlëshjeve në mes të nacionaliteteve të ndryshme dhe të imperializmit rus dhe austriak, intelektualët arbëreshë filluan të kultivojnë iluzionin romantik të vëllazërimit dhe të lirisë së të gjithë popujve. Italia do të duhet të angazhohej për lirinë e Shqipërisë dhe dy popujt "vëllezër" nuk do të kishin tjetër synim përveçse lidhjen e dashurisë dhe të marrëveshjes.

Edhe në vitet që i paraprinë shpërthimit të Luftës I Botërore, kur u pa qartë se midis popujve mbizotëronë interesa të tjera dhe jo ndjenja, arbëreshët vazhdonin të këmbëngulnin mbi këtë koncept naiv. "Shqipëria dhe Italia duhet të jetojnë si dy motra besnike, me respekt ndaj njëra-tjetrës, në

bashkëpunim për interesat e larta të drejtësisë ndërnacionale, qytetërimin dhe paqes. Ky qëndrim do të mbështetej shpesh dhe, me ardhjen e fashizmit, profesioni i fesë demokratike u bë një instrument në politikën e italo-shqiptarëve edhe në Shqipëri, ku siç dihet "vëllazëria" dhe "bashkëpunimi" nuk



Terenc Toçi

qenë tjetër, veçse humbje e pavarësisë dhe pushtim konkret i huaj, i cili u shoqërua me humbjen e pavarësisë. Në thelb, gjithë ky diskutim i madh mbi Shqipërinë dhe pavarësinë e saj ishte thjeshtë retorikë dhe akademizëm që përfshinte dhe popullësinë shqiptare, në masë të madhe analfabete të dyfishtë, si në gjuhën e vet shqipe edhe në gjuhën italiane dhe, nuk ishte në gjendje të kuptonte çfarë po ndodhte dhe, që informacionet e merrte nga një grup i vogël intelektualësh të izoluar, të palidhur me problemet konkrete të komunitetit të tyre dhe për më tepër ishin shprehës të një borgjezie fshatare në krizë të identitetit dhe në kërkim të një pune, për rrjedhojë e pakënaqur dhe e etur në aventurën e pamundur të krijimit të një Atdheu të ëndërrave.

Kjo borgjezi e vogël rurale, e mbyllur ndaj angazhimeve të vogla qytetare në ndihmë të komunitetit të vet, akoma e prapambetur në zhvillimin qytetar, pa shkolla publike dhe private, që duhet të kenë struktura bazë qytetare, varfëruar prej emigracionit masiv transoqeanik, i dha ndjenjë fantazisë së vet, duke mbyllur sytë para realitetit që i rrethonte, që po shkonte ngadalë drejt fashizmit dhe duke harruar traditën fisnike demokratike rilindëse të popullsisë shqiptare të Kalabrisë.

Nëse diskutohet mbi gjuhën letrare të përbashkët, në mënyrë abstrakte dhe utopike, problemi i vendosur në terma elitare u intereson vetëm pak personave dhe jo shumicës së popullsisë që përdor vetëm gjuhën lokale dhe është plotësisht analfabete. Askush nuk dyshonte, madje as vetë De Rada se "shpëtimi" i gjuhës shqipe nuk do të kishte kuptim, nëse finalizohet me ruajtjen e një "monumenti të mbijetuar të antikitetit klasik". Por gjuha i shërben pop-

ullit dhe është një instrument i gjallë i komunikimit dhe, prandaj ishte e nevojshme të lidhet arësyea e mbijetesës së gjuhës në popullsinë që e flet, të cilës i duhet dhënë mundësia efektive të vazhdojë të mbetet në vendet e vjetra, duke nxitur veprimtarinë ekonomike, pa i detyruar banorët të emigrojnë, që pastaj të asimiloheshin në grupe të tjera të popullsisë, duke humbur plotësisht identitetin e vet kulturor.

Kozmo Serembe, në vitet tetëqind, kishte themeluar në San Cosmo "Shqipërinë e Re" që kishte si program "Shqipërinë e bashkuar, të lirë dhe të pavarur" dhe ndërhyri me publikime të përshtatshme në çështjen e ashtuquajtur "Alfabeti Nacional", duke propozuar adoptimin e atij alfabeti që ishte aprovuar në Kuvendin e Stambollit të vitit 1789 dhe në çështje politike që kishin lidhje me debatin që po zhvillohej për bashkimin me Malin e Zi. Ky debat akademik në mes të intelektualëve shërbeu për ta mbajtur çështjen shqiptare në qendër të vëmendjes së opinionit publik, që do të gjente zgjidhje vetëm pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore në ekuilibrat delikate të interesave të Fuqive të Mëdha.

Deri në vitin 1912, Shqipëria kishte qenë nën sundimin turk. Për dy herë rrjesht, në vitet 1883 dhe 1885, shqiptarët ishin ngritur kundër sundimit osman, pa asnjë mbështetje të arbëreshëve. Kjo lëvizje antiturke, që shtypej gjithmonë nga turqit, pas Traktatit të Berlinit, kishte rifilluar përsëri në verën e vitit 1911 nga malësorët katolikë të Malësisë së Shkodrës, të mbështetur nga nacionalisti Isa Boletini. Qe një rezistencë e dëshpëruar, një luftë nëpër male kundër barbarit Turgut Pasha që zgjati disa javë.

Edhe pse përfundoi me dështim të plotë ushtarak, ajo qe e nevojshme për të bërë të njohur situatën dramatike të shqiptarëve përpara Fuqive të Mëdha të kohës.

Çështja shqiptare përbënte për Rusinë, Austro-Hungarinë, Italinë dhe Ballkanin një vend ku përplaseshin interesat, në momentet kur po kërkohesh një zgjidhje, në bazë të lëshimeve që u premtuan turqit shqiptarëve, që mbeti pa u realizuar për shkak të shpërthimit të Luftës Ballkanike, në tetor të vitit 1912.

Angazhimi i Terenc Toçit për Pavarësinë e Shqipërisë. Terenc Toçi qe ndoshta arbëreshi i vetëm që shkoi në Shqipëri, mori shtetësinë shqiptare dhe bëri pjesë në udhëheqjen politike të këtij vendi deri në vitin 1943. Sipërmarrja e tij politike dhe njerëzore qe e lodhëshme dhe përfundoi në mënyrë tragjike, pse nuk u mbështet mbi asnjë bazë morale. Historia nuk merret me dhënien e dënimit ose të faljes, por priret t'i kuptojë ngjarjet, shkaqet dhe pasojat, përmes njohjes së ngjarjeve reale në kompleksitetin e tyre.

Lindi me 9 mars 1880 dhe përfundoi studimet në Kolegjin e Shën Adrianit, që vazhdonte të mbante ende traditën laike dhe liberale. Pas disa vitesh, një zënkë me një mësues bëri që ta përjashtonte nga shkolla. Pesëmbëdhjetë vjeç, në vitin 1895 mori pjesë në Kongresin e parë Gjuhësor Arbëresh të drejtuar nga Jeronim De Rada në lokalet e Garopolit në Koriljano Kalabro. Përfundoi studimet në Urbino dhe

fitoi diplomën në Jurisprudencë në fillim të viteve nëntëqind. Ushtroi profesionin për pak kohë në Romë.

Pasioni i tij ishte gazetaria politike. Nga republican dhe mazinian në faqet e "Italisë së Tretë", të drejtuar nga Felice Albani, u interesua për qëndrimet e partisë maziniane ndaj çështjes shqiptare. Me publikimin e "La Question Albanese", në vitin 1901, në kundërshtim me vendimet e Kongresit Gjuhësor të Koriljano Kalabros, mendonte se alfabeti dhe letërsia nuk ishin të nevojshme në ato momente, por kërkohesh një veprim i menjëhershëm. "Kur një popull dëshiron të jetojë i lirë nuk bën politikë, por luftë; nuk u drejtohet diplomatëve, por kurajos së vet dhe preferon më mirë analfabetizmin se sa kulturën që i japin të huajt. Për të përzënë të huajt nga vendi, duhet zhvilluar vetëdija nacionale, që atje ekziston. Vetëdija nacionale te shqiptarët ekziston dhe nuk ka nevojë të dihet shkrimi dhe leximi, kur duhet të largohet i huaji nga Atdheu, mjafton që të urrehet ai dhe të kuptohet se askush nuk ka të drejtë ta ngacmonte këtë vend në asnjë mënyrë dhe për asnjë arsye".

Në mes të viteve 1906 dhe 1912, Toçi themeloi dy periodikë: "Korrieri i Ballkanit" dhe "Shpresa e Shqipërisë", në të cilat u mor me çështjen shqiptare. Tashmë është e qartë se i gjithë angazhimi i tij duhet t'i shërbejë Pavarësisë së Shqipërisë. Për të riun mazinian ky ishte "Atdheu i ëndërrave", nën valët nacionaliste që e kishin hedhur Europën në konflikte të përgjakëshme dhe ai u përpoq të pajtonte interesat politike italiane me ato shqiptare për liri dhe përfitime të ndërsjellta. Me karakteristikat e periudhës së parë të nacionalizmit, me përfshirjen e Italisë në lojërat diplomatike ndërkombëtare, në klimën e ndezur nacionaliste, po bëhej gjithnjë e më shumë problem gjetja e interesave të përbashkëta në të dy anët e Adriatikut.

Në vitet 1908-1910, Terenci shkoi në Amerikë për të vizituar komunitetin shqiptar dhe arbëresh të atjeshëm, në përpjekje për të grumbulluar fonde për organizimin e një lëvizje të protestës në të gjithë Shqipërinë, me synimin për të tërhequr vëmendjen e botës së qytetëruar mbi çështjen shqiptare.

Në vitin 1911, Terenc Toçi kaloi në Shqipëri me porosi të Gjeneralit Ricciotti Garibaldi, për të formuar një Qeveri të Përkohëshme, që do të kishte të drejtë të kërkonte ndihmën e një ekspedite vullnetarësh. Toçi, i mbështetur nga disa krerë të malësive shqiptare krijoi një Qeveri të Përkohëshme në Mirditë.

Gazeta "Tribuna shqiptare", date 26 prill 2013

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri,
Prele Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja,
Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja